# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5808
E shtunë, 22 qershor 2019
çmimi 0.40 €


## Anulohet takimi i Parisit FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", MIMOZA KUSARI-LILA FAQE 4-5

# E vetmja zgjidhje janë zgjedhjet



Kryetarja e Alternativës, deputetja Mimoza Kusari-Lila, beson se zgjedhjet e parakohshme janë zgjidhja e vetme për të dalë vendi nga situata aktuale politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka shprehur optimizëm se qeveria Haradinaj do të rrëzohet përmes mocionit të mosbesimit. Kusari-Lila ka deklaruar se pret që gjatë muajit korrik disa deputetë të koalicionit qeverisës do ta përkrahin këtë mocion. Pas kalimit të mocionit të opozitës, sipas saj, zgjedhjet do të duhej të mbaheshin në verën e vonshme apo në vjeshtën e hershme. Kusari-Lila ka thënë se qeveria e ardhshme do të ishte mirë të bëhej nga opozita e tanishme

## OPINION

### NË RASTIN E KOSOVËS, EDHE SHKATËRRIMET JANË DËSHMI E QËLLIMIT TË SERBISË PËR GJENOCID F. 11

Bardhyl MAHMUTI



## Presioni i shoqërisë civile tërheq Projektligjin për financimin e partive politike



Në mbledhjen e radhës të Qeverisë së Kosovës do të tërhiqet Projektligji për financimin e partive politike nga Kuvendi. Kështu ka bërë me dije të premten kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka vlerësuar se tërheqja e këtij projektligji dhe ridërgimi i tij me bazë të mirë ligjore e demokratike është veprim i duhur. Tërheqja e këtij projektligji është bërë pas protestave dhe presionit të shoqërisë civile FAQE 3

## Opozita kundërshton takimet e fshehta me Serbinë FAQE 5



## AKTUALE

### JAGXHILLARI: DO TA STANDARDIZOJMË KOSOVËN ME ADMINISTRATAT E TJERA EVROPIANE F. 5

### SERBIA PO PËRGATIT ‘KATASTROFË HUMANITARE’ NË VERI, HARADINAJ THOTË SE ËSHTË PROVOKIM F. 5

## EKONOMI

### FITIMI I ‘Z-MOBILE’-it NGA KONTRATA ME PTK-në ËSHTË MBI 5 MILIONË EURO F.8

## KULTURË

### FATOS BERISHA ZGJEDHET DREJTOR ARTISTIK I TEATRIT KOMBËTAR TË KOSOVËS F. 18

## SPORT

### NJOMZA EMINI: DITË E VEÇANTË PËR LËVIZJEN PARAOLIMPIKE F. 16




RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Rama: Nuk negociojmë demokracinë, zgjedhje në të gjithë Shqipërinë

**Tiranë, 21 qershor**- Zgjedhjet do të mbahen në gjithë Shqipërinë, ata që përpiqen t'i pengojnë janë gabim, luajnë me zjarrin, sepse djegin veten në raport me ligjin, dhe ligjet janë të qarta.
Kështu deklaroi të premten kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë".
"Zgjedhjet kanë një administratë zgjedhore, një gjykatë zgjedhore bazuar edhe në opinion e kahershëm të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, çdo problem i kujtdo me zgjedhjet adresohet në Gjykatën Speciale Zgjedhore dhe askund tjetër. Janë përpjekje të dëshpëruara, të cilat nuk kanë asnjë shans që të përmbysin bazën e rregullave të bashkëjetesës demokratike. Nuk është problemi që unë insistoj të shkoj në zgjedhje, unë insistoj që të respektohet Kushtetuta dhe e drejta e popullit për të zgjedhur", tha Rama.
Duke iu përgjigjur interesit të "Radio Evropa e Lirë" për përgjimet e publikuara në Gjermani nëse është i gatshëm të përballet me akuzat dhe si do t'i adresojë ato, Rama theksoi se "Këto nuk janë zbulime gjermane, këto janë përgjime të Prokurorisë shqiptare, të cilat në mënyrë të paligjshme janë keqpërdorur duke thyer rëndë sekretin hetimor dhe përgjigja është thjesht përsëri, e dhimbshme, por e thjeshtë. Përgjimet janë kthyer nga një bazë për të hetuar në një ushqim për të helmuar njerëzit dhe opinionin ndërkombëtar në prag të çeljes së negociatave. Sepse gjithçka po ndodh në Shqipëri është një përpjekje për të frenuar çeljen e negociatave. Pse? Sepse me çeljen e negociatave fillon bashkëbisedimi për anëtarësim me kapitujt e drejtësisë", tha Rama.




# Anulohet takimi i Parisit

Diplomatë perëndimorë kanë konfirmuar se nuk do të mbahet takimi i Parisit, nismë e kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit francez Emanuel Macron që shihet si një mundësi për t'i rifilluar bisedimet e pezulluara në kërkim të një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë



**Prishtinë, 21 qershor** - Takimi i Parisit, nismë e kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit francez Emanuel Macron, për të zhbllokuar bisedimet ndërmjet Kosovës e Serbisë, nuk do të mbahet.
Kjo u bë e ditur për "Zërin e Amerikës" nga diplomatë perëndimorë, të cilët konfirmuan se takimi nuk është në agjendë.
Shpresat që Parisi të ndodhë, u shuan pas një takim të nivelit teknik ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë, që është mbajtur në Berlin një ditë më parë, larg syve të opinionit.
Këshilltari i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, Selim Selimi dhe ish-udhëheqësi i bisedimeve teknike, Avni Arifi, janë takuar me një delegacion të Serbisë, i kryesuar nga shefi i zyrës për Kosovën, Marko Gjuriq.
Temë e diskutimeve ishte hapja e mundësive për t'i vazhduar bisedimet dhe përgatitjet për takimin e Parisit, por siç thanë në Qeverinë e Kosovës edhe për t'i diskutuar mundësitë e zbatimit të marrëveshjeve të arritura në bisedimet e ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian.
Por, të dyja palët kanë ngulur këmbë në qëndrimet e tyre. Derisa Serbia kërkoi heqjen e tarifave ndaj mallrave serbe si kusht për t'i vazhduar bisedimet, Kosova kërkoi që të mos vihen kushte për bisedimet.
Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha të premten nga Bjellorusia, tha se nuk do të ketë takim në Paris dhe se sipas tij edhe gjermanët edhe francezët e kanë kuptuar se kush nuk dëshiron bisedime dhe kush i frenon ato.
Qeveria e Kosovës në një përgjigje dhënë "Zërit të Amerikës", tha se "kryeministri Ramush Haradinaj vazhdimisht ka theksuar se Kosova është e gatshme të ulet në tavolinë, por pa kushte për bisedime dhe kërkon me ngulm një kornizim të dialogut dhe një marrëveshje përfundimtare që çon në njohje të dyanshme".
Kosova e Serbia po përballen me trysni ndërkombëtare për të rifilluar procesin e bisedimeve, proces ky që mbetet i bllokuar që nga nëntori i vitit të kaluar, pas vendosjes së tarifave nga Qeveria së Kosovës ndaj mallrave serbe.
Takimi i Parisit, ishte parë si një mundësi për t'i rifilluar bisedimet e pezulluara në kërkim të një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve, që është kusht për proceset integruese të tyre.

## Zaev: Emrat e ministrave, të dielën në Kuvend

**Shkup, 21 qershor** - Kryeministri Zoran Zaev nesër (e diel) pritet që të dorëzojë listën me emrat e ministrave të rinj në Kuvend. I pari i ekzekutivit nuk zbuloi asnjë emër nga kuadrot e reja, por tha se ditën kur do të dorëzohet lista do të publikohen edhe emrat.
"Vendimet tanimë janë marrë. Të dielën pasdite unë do t'i dorëzoj në Parlament materialet për të gjithë ndryshmet që do të ndodhin në Qeverinë e Maqedonisë Veriore dhe atëherë do t'i jap të gjitha detajet në lidhje me emrat sepse e kemi parim që pasi të kompletohet ndryshimi atëherë edhe të bëhen publike", tha Zaevi.
Ai tha se do t'i shqyrtoj edhe propozimet e partive tjera.
"Partitë politike do t'i propozojnë kandidatët e tyre më të mirë, kanë favoritët e tyre por në fund të fundit, mandatar është Zaev dhe ai duhet të shoh se cilat janë vendimet më të pranueshme dhe se si më mirë t'ju shërbejmë qytetarëve duke e mbajtur së bashku koalicionin politik gjithashtu, që më në fund të mund të ju japim deputetëve vendimet më të mira të mundshme që nga ta të presim vendime pozitive", tha Zaevi.
Alsat mëson se Hisni Ismajli do ta zëvendësojë Asaf Ademin në Ministrinë e Kulturës. Nga BDI konfirmojnë se Naser Nuredini do të drejtojë Ekologjinë, ndërsa Sadulla Duraku do të kalojë në Ministrinë për Sistem Politik. Pushteti Lokal mbetet në lojë edhe si propozim që t'i jepet Partisë Liberal Demokrate, ndërsa Ministria pa resor për përmirësimin e klimës për bizneset e brendshme pritet t'i kalojë njërës nga partitë rome. Nga radhët e LSDM-së, ministër i ri pritet në Bujqësi, ndërsa mësohet edhe për ministrin e Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugarevski dhe një ministri pa resor.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria paralajmëron tërheqjen nga Kuvendi të Projektligjit për financimin e partive politike

# Presioni i shoqërisë civile tërheq Projektligjin për financimin e partive politike

Në mbledhjen e radhës të Qeverisë së Kosovës do të tërhiqet Projektligji për financimin e partive politike nga Kuvendi. Kështu ka bërë me dije të premten kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka vlerësuar se tërheqja e këtij projektligji dhe ridërgimi i tij me bazë të mirë ligjore e demokratike është veprim i duhur. Tërheqja e këtij projektligji është bërë pas protestave dhe presionit të shoqërisë civile




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të premten ka paralajmëruar se në mbledhjen e radhës të kabinetit qeveritar do të tërhiqet Projektligji për financimin e partive politike nga Kuvendi i Kosovës. "Pas shqetësimeve të ngritura nga shoqëria civile sa iu përket ndryshimeve që i janë bërë Projektligjit për financimin e partive politike gjatë punës në komisionet parlamentare, kam propozuar që në mbledhjen e radhës të Qeverisë së Republikës së Kosovës të merret vendim për tërheqjen e këtij projektligji nga Kuvendi i Kosovës", ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri ka vlerësuar se tërheqja e këtij projektligji dhe ridërgimi i tij me bazë të mirë ligjore e demokratike është veprim i duhur. "Duke e ditur rëndësinë që ka ky projektligj për zhvillimin e demokracisë në vend, nevojës së transparencës në funksion të politikbërjes dhe përfshirjes së të gjitha palëve për krijimin e tij, tërheqja e projektligjit dhe ridërgimi i tij, me bazë të mirë ligjore dhe demokratike, është veprim i duhur!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Organizatat e shoqërisë civile e kanë vlerësuar lart paralajmërimin e qeverisë për tërheqjen e Projektligjit për financimin e subjekteve politike. "Shoqëria civile e vlerëson këtë veprim të kryeministrit dhe njëkohësisht ua rikujton të gjithë aktorëve politikë se janë të gatshëm ta vazhdojnë mbështetjen e tyre për institucionet vendore për ndërtimin e kornizës ligjore dhe institucionale që mundëson një sistem të subjekteve politike konform standardeve të shoqërive demokratike dhe një garë zgjedhore korrekte dhe te barabartë për të gjithë pjesëmarrësit", është thënë në komunikatën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI).

Në vazhdimin e kësaj komunikate është theksuar se paralajmërimi për tërheqjen e projektligjit ka ardhur pas fushatës disajavore të rreth njëqind organizatave të shoqërisë civile, gjatë së cilës, qytetarët dhe institucionet publike u njoftuan me disa nga dispozitat e draftit të fundit të projektligjit të cilat binin në kundërshtim me frymën kushtetuese dhe reformën zgjedhore të iniciuar rishtazi nga Kuvendi i Kosovës. "Projektligji aktual rrezikonte integritetin e procesit të reformës zgjedhore duke cenuar pavarësinë e Zyrës për Regjistrimin e Subjekteve Politike nga politika. Projektligji gjithashtu dështonte t'i adresojë prioritetet e identifikuara në Agjendën për Reforma Evropiane (ERA) për transparencë, llogaridhënie, zbatim dhe sanksionim efikas të financimit të partive politike. Për më tepër, ky projektligj ua ofronte subjekteve politike mundësinë për ta fshehur identitetin e kontribuuesve financiarë, shumëfishonte lartësinë e këtyre kontributeve, zgjaste afatet për publikimin e raporteve financiare të fushatës dhe zvogëlonte gjobat në rast se vlerësohej shkelja e ligjit nga ana e subjekteve", është thënë më tutje në komunikatën e KDI-së.

Shoqëria civile këto kërkesa i ka parashtruar edhe në protestën e së premtes para ndërtesës së Kuvendit të Kosovë, e cila është mbajtur një orë para se kryeministri Haradinaj ta paralajmëronte tërheqjen e projektligjit. Po ashtu, para se kryeministri ta paralajmërojë tërheqjen e këtij projektligji, kryetari i Komisionit Parlamentar Ad Hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, Avdullah Hoti, i ka bërë thirrje shoqërisë civile që ta ndërpresin bojkotin dhe të kthehen në këtë komision për ta dhënë kontributin e tyre. Ai ka thënë se pa pjesëmarrjen e shoqërisë civile nuk mund të përmirësohet procesi zgjedhor në Kosovë. "Projektligji për të cilin organizatat e shoqërisë civile me të drejtë po kundërshtojnë, tani për tani nuk bie në kompetencën e këtij Komisioni Parlamentar. Në cilësinë e kryetarit të këtij Komisioni Parlamentar i ftoj këto organizata të vazhdojnë të japin kontributin në grupin këshillëdhënës që t'i adresojmë në mënyrë cilësore rekomandimet e vëzhguesve të BE-së, ashtu siç e kemi paraparë me planin e punës të Komisionit. Pa pjesëmarrjen e shoqërisë civile nuk besoj se mund të bëhet përmirësim substancial i procesit zgjedhor në Kosovë", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka theksuar se ky komision ka synim kryesor adresimin e rekomandimeve të vëzhguesve të zgjedhjeve nga BE-ja.

Hoti ka shprehur optimizëm se do të arrihet konsensusi në Kuvend për të pasur një ligj për financimin e partive politike që është në përputhje me standardet e BE-së.

"Besoj se në Kuvendin e Kosovës do të arrijmë të ndërtojmë konsensusin e nevojshëm për një ligj për financimin e partive politike që është në përputhje me standardet e BE-së dhe që siguron financim dhe raportim transparent të partive politike, që siguron llogaridhënie të partive politike ndaj qytetarëve dhe votuesve", është shprehur ai, duke shtuar se asnjë projektligj e aq më pak ky për financimin e partive politike i cili bie ndesh me frymën kushtetuese dhe parimet zgjedhore sipas standardeve të BE-së nuk do të përkrahet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Për shkak të pakënaqësisë me Projektligjin për financimin e partive politike organizatat kryesore të shoqërisë civile ditë më parë e kanë pezulluar pjesëmarrjen në Komisionin Parlamentar Ad Hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor.

## Kuvendi të hënën mban seancë të jashtëzakonshme për 'gulenistët'

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës të hënën në orën 11:00 do të mbajë seancë të jashtëzakonshme për ta shqyrtuar raportin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq. Vendimi për mbajtjen e kësaj seancë është marrë në mbledhjen e së premtes të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Ndërsa kërkesa për seancë të jashtëzakonshme është iniciuar nga deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), njëherësh kryetari i Komisionit Hetimor Parlamentar, Xhelal Sveçla dhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh nënkryetar i këtij komisioni, Driton Selmanaj. "31 shkeljet e gjetura nga ky komision hetimor dhe raporti i plotë janë miratuar nga vetë Komisioni Hetimor, por për shkak të zvarritjes nga Kryesia e Kuvendit, ende nuk kanë dalë në rend të ditës në seancë të rregullt. Në këto kushte deputetët iniciues dhe deputetët nënshkrues dorëzuan kërkesën zyrtare për seancë të jashtëzakonshme", është thënë në njoftimin për medie.



Flet për "Epokën e re", Mimoza Kusari-Lila

# E vetmja zgjidhje janë

Kryetarja e Alternativës, deputetja Mimoza Kusari-Lila, beson se zgjedhjet e parakohshme janë zgjidhja e vetme për të dalë vendi nga situata aktuale politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ajo ka shprehur optimizëm se qeveria Haradinaj do të rrëzohet përmes mocionit të mosbesimit. Kusari-Lila ka deklaruar se pret që gjatë muajit korrik disa deputetë të koalicionit qeverisës do ta përkrahin këtë mocion. Pas kalimit të mocionit të opozitës, sipas saj, zgjedhjet do të duhej të mbaheshin në verën e vonshme apo në vjeshtën e hershme. Kusari-Lila ka thënë se qeveria e ardhshme do të ishte mirë të bëhej nga opozita e tanishme



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja zgjidhje për vendin. Ajo beson se mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë do të jetë i suksesshëm dhe vendi do të shkojë shumë shpejt në zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kusari-Lila ka thënë se krejt çfarë po bën kjo qeveri është një ndarje e pushtetit në mes të partive të koalicionit qeverisës. "Zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje aktualisht për daljen nga situata aktuale dhe kthimi në binarë të proceseve në Kosovë. Ka humbur komplet orientimi i vendit për çfarëdo procesi zhvillimor. Krejt çka bëhet sot është një ndarje e pushtetit në mes të partive në koalicionin qeverisës në formën më të vrazhdët të mundshme, derisa shumë pak diskutohet për tema të cilat janë me peshë për qytetarët dhe të cilat do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës", ka thënë Kusari-Lila.

Ajo ka treguar se vera e vonë apo vjeshta e hershme është koha më e përshtatshme për zgjedhje të reja. "Mendoj se koha më e mirë për zgjedhje të parakohshme do të ishte vjeshta e hershme apo vera e vonë sepse, pas shpërbërjes së Kuvendit, nënkuptohet se 30 deri në 45 ditë duhet të shkojë vendi në zgjedhje. Nëse mocioni i mosbesimit të qeverisë kalon gjatë muajit të ardhshëm, i bie që në Kosovë të ketë zgjedhje në verën e vonë apo vjeshtën e hershme", është shprehur ajo, duke shtuar se gjatë muajit të ardhshëm mocioni i mosbesimit do të përkrahet edhe nga deputetët e koalicionit qeverisës. "Besoj se mocionin do ta mbështesin edhe deputetët e Nismës dhe ata të PDK-së. Po ashtu, arsye të mjaftueshme për ta mbështetur këtë mocion kanë edhe deputetët e pakicave joserbe, sepse nuk është se në këtë mandat ka pasur avancim të pozitës së pakicave në Kosovë", ka thënë Kusar-Lila.

E para e Alternativës ka treguar se brenda pak javësh do të dihet se me kë ky subjekt politik do të bëjë koalicion parazgjedhor. Sipas Kusari-Lilës, qeveria e ardhshme duhet të përbëhet nga subjektet opozitare.

**"Epoka e re":** *Znj. Kusari-Lila, përsëri gjatë kësaj jave, në mungesë kuorumi, Kuvendi i Kosovës i ka ndërprerë punimet e një seance. Çfarë po ndodh me këtë legjislaturë?*

**Kusari-Lila:** Mbarëvajtja e punës së Kuvendit është për keqardhje. Ani pse sa i përket numrit të ligjeve që kemi miratuar dikush mund të thotë se kemi bërë si duhet. Besoj se kualiteti apo përmbajtja e seancave lë shumë për të dëshiruar. Në vazhdimësi, në muajit e fundit ka pasur kërkesa për seanca të jashtëzakonshme, përderisa pozita nuk ka arritur propozimet e veta t'i kalojë për shkak të mungesës së deputetëve të pozitës. Ndërsa ekziston një pakënaqësi e madhe në nivel vendi në raport me agjendën e përgjithshme të shtetit. Vërehet se kjo qeveri nuk i ka fokus proceset zhvillimore dhe ekziston një huti e përgjithshme. Krejt ajo që mund të themi, si për Kuvendin ashtu edhe për qeverinë, është se kur do të shkojmë në zgjedhje të kemi një ndryshim të strukturës legjislative dhe qeverisëse.

**"Epoka e re":** *Kur prisni që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme?*

**Kusari-Lila:** Mendoj se koha më e mirë për zgjedhje të parakohshme do të ishte vjeshta e hershme apo vera e vonë, sepse pas shpërbërjes së Kuvendit nënkuptohet se 30 deri në 45 ditë duhet të shkojë vendi në zgjedhje. Nëse mocioni i mosbesimit të qeverisë kalon gjatë muajit të ardhshëm, i bie që në Kosovë të ketë zgjedhje në verën e vonë apo vjeshtën e hershme. Mendoj se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje aktualisht për daljen nga situata aktuale dhe kthimi në binarë të proceseve në Kosovë. Ka humbur komplet orientimi i vendit për çfarëdo procesi zhvillimor. Krejt çka bëhet sot është një ndarje e pushtetit në mes të partive në koalicionin qeverisës në formën më të vrazhdët të mundshme, derisa shumë pak diskutohet për tema të cilat janë me peshë për qytetarët dhe të cilat do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Subjektet opozitare që një kohë kanë filluar mbledhjen e nënshkrimeve për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Sa besoni se mund të ketë sukses kjo iniciativë kur dihet se opozitës i duhen edhe disa vota të pozitës për ta rrëzuar qeverinë?*

**Kusari-Lila:** Besoj se deputetët e pozitës menjëherë pas plotësimit të dyvjeçarit të mandatit të plotë të deputetit nuk do të kenë hezitim për ta përkrahur këtë mocion. Në një mënyrë apo në tjetër, duhet të ketë ndryshime në Kosovë. Prandaj, unë nuk kam asnjë dyshim se ka deputetë të përgjegjshëm të pozitës që ia duan të mirën vendit dhe të cilët i shohin zgjedhjet si rrugë të vetme për të dalë vendi nga kriza aktuale. Pres që gjatë muajit korrik të kemi deputetë të pozitës të cilit publikisht do të kërkojnë ndryshime në qeverisje dhe rrjedhimisht ta mbështesin mocionin e mosbesimit. Personalisht mocionin e kam nënshkruar qysh në fillim dhe tashmë jemi në pritje të asaj se kur do të mund ta mbërrijmë numrin 61.

**"Epoka e re":** *Kush prej deputetëve të pozitës besoni se do të mund ta mbështesë mocionin. Të PDK-së, Nismës apo të minoriteteve?*

**Kusari-Lila:** Besoj se mocionin do ta mbështesin edhe deputetët e Nismës dhe ata të PDK-së. Po ashtu, arsye të mjaftueshme për ta mbështetur këtë mocion kanë edhe deputetët e pakicave joserbe, sepse nuk është se në këtë mandat ka pasur avancim të pozitës së pakicave në Kosovë. Pra, gjendja e pakënaqësisë me këtë qeverisje është në tërë spektrin shoqëror.

**"Epoka e re":** *Mirëpo shumëkush është skeptik se as zgjedhjet nuk po sjellin ndonjë ndryshim. Çka ju bën të besoni se kësaj radhe mund të ndodhë ndryshimi?*

**Kusari-Lila:** Është e vërtetë që kemi pasur zgjedhje të shpeshta, por asnjëherë nuk kemi pasur degradim të qeverisjes siç e kemi

# zgjedhjet



sot. Së dyti, kjo qeveri ka vendosur standard të ri të ulët në raport me emërimet politike, në raport me skandalet, me përgjegjësinë publike dhe fjalën e dhënë. Kështu që, nuk ka shanse që një qeveri tjetër t'ua kalojë skandaleve të kësaj qeverie aktuale. Gjithsesi se duhet punuar për ndryshim. Besoj shumë se qytetarët e republikës e kanë të qartë tashmë se sa është kapaciteti i secilës parti. Besoj në një proces ku ka marrëveshje të mirëfilltë dhe transparencë mes forcave politike me një program të qartë mund të bëhet ndryshimi. Nuk do të ndodhë ndryshmi me shkop magjik në Kosovë, as me qeverisjen e ardhshme por, domosdoshmërisht, duhet të ndalet degradimi dhe të fillojnë proceset të ecin përpara.

**"Epoka e re":** *Në rast se zgjedhjet e parakohshme mbahen së shpejti, Alternativa ka menduar se me kë mund të bëjë koalicion parazgjedhor?*

**Kusari-Lila:** Alternativa është në një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha subjektet opozitare. Kemi pasur bashkërendim edhe me LDK-në dhe Lëvizjen Vetëvendosje. Ndërsa kemi pasur edhe organizime të aktiviteteve të përbashkëta me LV-në, të cilën e kemi mbështetur nëpër disa aktivitete që ka zhvilluar nëpër disa komuna. Mendoj se brenda pak javësh do të kemi një përcaktim të qartë rreth partnerit tonë të mundshëm në koalicionin parazgjedhor. Besoj se do të jemi në koalicion parazgjedhor, sepse ajo çfarë kanë treguar proceset e deritanishme pas zgjedhjeve, pra vendimi i Gjykatës Kushtetuese është bërë domosdoshmëri përafrimi i programeve të partive dhe bashkërendimi i programeve qeverisëse. Prandaj, do të ishte mirë edhe për ndryshimet që pas zgjedhjeve të kemi një konsultim të spektrit opozitar që nga ky formacion të bëhet qeveria e ardhshme.

# Opozita kundërshton takimet e fshehta me Serbinë

Takimi i mbajtur në Berlin në mes të Avni Arifit dhe Marko Gjuriq, si vazhdim i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, është kundërshtuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD). Këto dy parti politike kanë theksuar se ky takim i fshehtë dhe pa kurrfarë paralajmërimi e konsultimi është i papranueshëm dhe shumë i dëmshëm për zhvillimet politike në Kosovë e në dialogun me Serbinë

**Prishtinë, 21 qershor (ER)** - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) kanë kundërshtuar takimet e fshehta me Serbinë. Sipas LDK-së, takimi i fshehtë i përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës dhe atyre të Serbisë në Berlin për këtë subjekt politik është i papranueshëm dhe tejet i rrezikshëm. "Dialogu nuk ka arsye të fshihet pa marrë parasysh nivelin e tij dhe çështjeve që diskutohen në dialog. Gabojnë edhe shtetet e BE-së në qoftë se kultivojnë një praktikë të tillë sepse e bën procesin e dialogut të pabesueshëm për ne dhe për qytetarët e Kosovës. Veprime të tilla vënë në dyshim transparencën që mund të presë Kosova nga dialogu, kur jo vetëm që qytetarët e saj nuk janë informuar paraprakisht për përmbajtjen e takimit të djeshëm, por edhe vetë takimi është mbajtur fshehurazi", është theksuar në komunikatën e kësaj partie.

LDK-ja thotë se dialogu Kosovë - Serbi duhet të zhvillohet me mbështetje të domosdoshme të ShBA-së dhe me ndërmjetësim të komisionit të ardhshëm të BE-së. "Për takime të fshehta është përmendur më parë presidenti i vendit, ndërsa tani po dëshmohet se në të njëjtën rrugë është edhe qeveria. Mos të habitemi, në qoftë se pas disa dite do të dëgjojmë edhe për një takim të fshehtë në Beograd ndërmjet përfaqësuesve të dy qeverive, që është shkelje absolute e principeve të dialogut. LDK-ja është e bindur se dialogun nuk mundet dhe nuk duhet ta udhëheqë ky koalicion qeverisës dhe as presidenti i vendit. Që të kemi dialog përmbajtjesor dhe të përgjegjshëm duhet të mbahen zgjedhjet, të dalë një qeveri me besim të qytetarëve dhe të arrihet pajtueshmëri e gjerë", është thënë në komunikatën e LDK-së.

Partia Socialdemokrate (PSD) ka vlerësuar se takimi i mbajtur në Berlin në mes të Avni Arifit dhe Marko Gjuriqit si vazhdim i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë ashtu i fshehtë dhe pa kurrfarë paralajmërimi e konsultimi është i papranueshëm dhe shumë i dëmshëm për zhvillimet politike në Kosovë e në dialogun me Serbinë. "Përmes Rezolutës për dialogun që themelon delegacionin shtetëror dhe Ligjit për Delegacionin që ia sanksionon këtij të fundit kompetencat dhe përgjegjësitë, deputetët e Kuvendit të Republikës janë përcaktuar për tjetër format të dialogut, vendimmarrja për të cilin i takon Kuvendit. Ky mekanizëm për herë të parë ka sjellë në Kosovë vendimmarrje demokratike, transparente e legjitime për sa i përket procesit të dialogut me Serbinë si dhe ka krijuar mekanizëm për konsensus politik dhe shoqëror. Takimet e tilla të fshehta bien ndesh me të gjitha parimet fundamentale që përfaqëson delegacioni: pra është takim jotransparent, larg syve të deputetëve e publikut, pa kurrfarë legjitimiteti", është thënë në deklaratën e kësaj partie.

Të premten kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në takim kryetarin e Kuvendit, Kadri Veselin, me të cilin kanë biseduar për zhvillimet e fundit politike në vend. Haradinaj ka thënë se në këtë takim e ka njoftuar Veselin për ecurinë e takimit në Berlin në mes të përfaqësuesve të zyrës së kryeministrit, kancelares Merkel, presidentit Macron dhe palës serbe. "Ky takim kishte për qëllim evidentimin e zbatimit të marrëveshjeve nga dialogu teknik dhe çka duhet të bëhet në vazhdim. Në këtë takim Kosova i ka raportuar Berlinit zyrtar që Kosova i ka zbatuar të gjitha marrëveshjet e Brukselit dhe është e gatshme të vazhdojë këtë dialog, tashmë të kornizuar, që çon në një marrëveshje finale, ligjërisht të obligueshme dhe që rezulton me njohje reciproke në kufijtë ekzistues", ka thënë Haradinaj.



## Ministri Gashi miraton Strategjinë Kombëtare për Forcimin e Sistemit të së Drejtës së Autorit 2019-2023



PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Forcimin e Sistemit të së Drejtës së Autorit 2019-2023. Me këtë rast, ministri Gashi u shpreh se Strategjia Kombëtare ofron një plan qartë e të detajuar përmes të cilit të gjitha palët e interesit mund të punojnë së bashku për t'i promovuar dhe mbrojtur të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta si dhe ta inkurajojnë kreativitetin, për një kulturë më të pasur dhe ekonomi më të zhvilluar. "Për ta arritur përmbushjen e objektivave të Strategjisë është paraparë që në pesë vjetët e ardhshëm të ndërmerren veprime të vazhdueshme të cilat kanë të bëjnë me avancimin e kornizës legjislative, nxjerrjen e ligjeve dhe akteve nënligjore me qëllim të adresimit të çështjeve si dhe harmonizimin e plotë me legjislacionin e BE-së, forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve përgjegjëse dhe një sërë aktivitetesh të tjera", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka theksuar se qëllimi i aktiviteteve të lartpërmendura është ngritja e nivelit të vetëdijes për fushën e të drejtave të autorit, nxitja e krijimtarisë kreative, ulja e nivelit të piraterisë dhe përforcimi i sistemit të të drejtave të autorit. "Misioni i Strategjisë është zhvillimi i një sistemi Kombëtar për të Drejtën e Autorit që inkurajon krijimtarinë intelektuale duke rezultuar në zhvillim ekonomik, social dhe kulturor të Kosovës", është shprehur ministri Gashi, duke i siguruar autorët dhe krijuesit që Strategjia e miratuar do të sjellë zbatim më efektiv të të drejtave të tyre.

Ai në fund u bëri thirrje të gjitha palëve të punojnë së bashku që e drejta e autorit të mbrohet e të respektohet.

# Kryetari i Supremes bën thirrje për zbatim të Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Pas publikimit të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, në të cilin përmendet nxjerrja e Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore nga Gjykata Supreme, si përpjekje për zbatim të drejtë të ligjit dhe zbatim korrekt të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, njëherësh kryesues i Komisionit për Politikë Ndëshkimore, kërkon nga të gjitha aktorët e sistemit të drejtësisë, posaçërisht nga gjyqtarët dhe prokurorët, që ta marrin parasysh dhe ta zbatojnë këtë Udhëzues. "Gjyqësori ka zvogëluar numrin e përgjithshëm të lëndëve të grumbulluara dhe Gjykata Supreme ka miratuar Udhëzues për Politikë Ndëshkimore, në përpjekje për të siguruar që gjykatësit të aplikojnë faktorë rëndues dhe lehtësues, në mënyrë korrekte dhe të barabartë, duke përfshirë rastet e trafikimit", thuhet në raportin e publikuar të DASh-it, sipas të cilit, "gjyqtarët vazhduan të vendosin dënime të dobëta për trafikantët e dënuar".

Ndaj, në kuadër të gjetjeve të evidentuara në këtë raport të rëndësishëm për Kosovën, dhe në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për ta unifikuar politikën ndëshkimore në vend, kreu i Supremes, Peci, ka bërë thirrje publike për kolegët gjyqtarë dhe prokurorë, që ta zbatojnë Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për politikë ndëshkimore, si një mjet i lehtë dhe efikas për rritjen e cilësisë së vendimeve dhe, mbi të gjitha, për vendosjen me drejtësi, për secilin rast, përfshirë këtu edhe rastet e trafikimit të qenieve njerëzore.

Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka falënderuar shtetin amerikan dhe Ambasadën Amerikane në Prishtinë për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë për forcimin e pushtetit gjyqësor në vend.



## Ministri Mustafa pranon raportin e DASh-it për trafikim të qenieve njerëzore

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, në takim me Oliver Mains, zyrtar politik pranë Ambasadës së ShBA-së, ka pranuar raportin vjetor të Departamentit Amerikan të Shtetit për trafikim të qenieve njerëzore. Në këtë raport janë theksuar nëntë rekomandime të cilat iu referohen nevojave për rritjen e efikasitetit në parandalimin, luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe kujdesin për viktimat e trafikimit.

Sipas raportit të DASh-it, Republika e Kosovës vazhdon të rangohet në nivelin e dytë nga tri nivelet themelore, por raporti ka parasysh përpjekjet domethënëse të Qeverisë së Kosovës. Rrjedhimisht, sipas raportit, Republika e Kosovës ka shënuar përparim të dukshëm krahasuar me raportin e vitit të kaluar dhe raportet e tjera paraprake.

Ministri Mustafa ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë, e veçanërisht ShBA-në, për përkrahjen e vazhdueshme në fushën e luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore, kurse është zotuar se në koordinimin me ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore do të angazhohet për përmbushjen e rekomandimeve të dala nga raporti i DASh-it, veçanërisht për një rregullativë ligjore më efikase për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.



# Jagxhillari: Do ta standardizojmë Kosovën me administratat e tjera evropiane

"Ne jemi të vendosur të punojmë për ofrimin e shërbimeve të mira për qytetarët dhe bizneset në mënyrë që administrata publike të jetë sa më efikase, transparente dhe llogaridhënëse. Përmes reformave të reja, Ministria e Administratës Publike, si përgjegjëse për politikat në Administratën Publike, në veçanti në shërbimin civil, ka përzgjedhur prioritetet që ta standardizojë Kosovën me administratat e tjera evropiane", kështu ka thënë ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Shërbimit Civil



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Për nder të 23 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Shërbimit Civil, Ministria e Administratës Publike ka organizuar shënimin e kësaj dite, e cila i dedikohet shërbimit civil në Republikën e Kosovës. Këtë ceremoni rasti e shpalli të hapur ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, i cili ka thënë se shënimi i kësaj dite në Republikën e Kosovës ka një rëndësi të veçantë, sidomos në këtë vit kur Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi, me propozim të Ministrisë së Administratës Publike, ka miratuar pakon ligjore për reformën në Administratës Publike, kërkesë kjo imediate edhe e Bashkimit Evropian. "Ne jemi të vendosur të punojmë për ofrimin e shërbimeve të mira për qytetarët dhe bizneset në mënyrë që administrata publike të jetë sa më efikase, transparente dhe llogaridhënëse. Përmes reformave të reja, Ministria e Administratës Publike si përgjegjëse për politikat në Administratën Publike, e në veçanti në shërbimin civil, ka përzgjedhur prioritet që ta standardizojë Kosovën me administratat e tjera evropiane", ka thënë Jagxhillar.

Ministri Jagxhillar ka folur edhe për Ligjin për zyrtarët publikë, duke theksuar se ky ligj do të ofrojë një model të ri të rekrutimit. "Përmes këtij ligji dëshirojmë t'i ofrojmë administratës publike nëpunës bazuar në parimin e meritës, konkurrencës së hapur, testimit dhe vlerësimit elektronik, ndërsa qytetarëve transparencë dhe llogaridhënie të organeve përgjegjëse", është shprehur ai.

Ministri Jagxhillar në këtë ceremoni ka folur edhe për ndryshimet dhe reformat në Ligjin për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe Ligjin mbi Pagat. "Një rëndësi të veçantë, në kuadër të organizimit të administratës, pa dyshim paraqet edhe racionalizimi i administratës publike/agjencive ekzistuese, që përbën njërin ndër objektivat e përgjithshme më me rëndësi të parapara në strategjinë e modernizimit të administratës publike. Kjo është bërë bazuar edhe në të gjeturat e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, në të cilat theksohet se organizimi i përgjithshëm i administratës së shtetit nuk është në favor të funksionimit të sistemit të llogaridhënies. Nga ajo që u tha, shihet qartë përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vendosjen e kornizës ligjore sa i përket organizimit të Administratës Publike, menaxhimit të burimeve njerëzore, pagave dhe llogaridhënies", ka thënë Jagxhillar.

Ai ka përmendur edhe raportin e përgatitur nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil. Ai ka thënë se për vitin 2018 shihet se është bërë përparim në reformimin e shërbimit civil dhe administratës publike për segmentet më të nevojshme, siç është hartimi i dokumenteve për politikën e re të shërbimit civil, hartimi i dokumenteve strategjike për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë dhe zbatimi i tyre.

Ministri Jagxhillar ka folur edhe për shtrirjen dhe përdorimin e mëtejme të Sistemit të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, katalogun e vendeve të punës, përshkrimin e standardizuar për pozitat me shtrirje të përgjithshme dhe për procesin e klasifikimit të vendeve të punës si dhe vendosjen në SIMBNJ.

Në fund të kësaj ceremonie për shërbyesit civilë të dalluar janë ndarë 86 mirënjohje.

# Serbia po përgatit 'katastrofë humanitare' në veri, Haradinaj thotë se është provokim

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Pas zbulimit të planit të Beogradit për "katastrofë humanitare" në veri të Mitrovicës, ka reaguar kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar të premten se përpjekjet nga aktorë të ndryshëm, zyrtarë dhe afaristë serbë në veri të Mitrovicës, të koordinuar me Beogradin zyrtar, për të paraqitur katastrofë humanitare në këtë pjesë të Kosovës, janë të papranueshme dhe të dënueshme. "Boshatisja e dyqaneve, ku nuk gjenden as artikuj elementarë me prejardhje nga Serbia, është plani që po përgatitet nga njerëz të caktuar në veri, për të cilën Qeveria e Kosovës është e informuar. Në bazë të këtyre informatave mësohet se pjesë e organizimit të këtij plani janë Radosh Petroviq, Goran Vllashkoviq, Bojan Jakshiq - Cojo, Sllavisha Staniq, Radulle Steviq. Sipas burimeve të mekanizmave të sigurisë së Kosovës, ky organizim do të asistohet me logjistikë dhe forma të tjera edhe nga organizata e ashtuquajtur 'Civilna Zastita' në veri, e cila udhëhiqet nga Stevo Paviçeviq", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se institucionet e Kosovës nuk do të rrinë duarkryq. "Ne nuk do të qëndrojmë duarkryq përballë këtyre tendencave për destabilizim dhe ftojmë kryetarët e komunave në veri dhe qytetarët të mos bien pre e këtyre provokimeve", ka shkruar Haradinaj.



# OAK-u kërkon nga Veseli përmbushjen e kërkesave të bizneseve

**Prishtinë, 21 qershor (ER)** - Heqja e udhëzimeve administrative nga MBPZhR-ja që kufizon në pesë vjet, pesë hektarë, 2 000 euro për hektar, heqja e taksës së dyfishtë të peshkut, rikthimi në Kuvend i Ligjit për miniera dhe minerale, Ligji i punës, pushimi i lehonisë, ishin arsyet e takimit të delegacionit të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.
Kryetari i Bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka falënderuar kreun e Kuvendit të Kosovës për takimin dhe i ka shprehur atij kërkesat të cilat po pengojnë zhvillimin e bizneseve në masë të madhe. "Ne si Odë e Afarizmit me bizneset që kanë rreth 50 mijë të punësuar kemi mundësi të mëdha të ndikojmë në zhvillimin e vendit, rritjen e mirëqenies, rritjen e ekonomisë së vendit, të rritet punësimi që është një nevojë e madhe", ka thënë ai.
Krasniqi kësaj radhe para kryetarit të Kuvendit paraqiti në mënyrë më specifike dy pikat kryesore të takimit, problemet e sektorit minerar në ndryshimin e udhëzimeve administrative që janë krijuar në vitin 2005, 2006 dhe 2010 e që po e pengojnë zhvillimin e këtij sektori, rritjen e punësimit dhe të hyrat në buxhetin e shtetit të Kosovës. Veseli u njoftua se në lidhje me këtë OAK-u së bashku me bizneset që tri vjet janë duke bërë peticione dhe kanë zhvilluar me dhjetëra takime me ministra të ndryshëm dhe kryeministra, por deri më tani nuk ka asnjë rezultat.
OAK-u ka kërkuar nga kryetari Veseli përkrahje për t'u mundësuar bizneseve vazhdimin e punës.



# Lekaj dhe Qalaj nënshkruajnë memorandum për regjistrim të automjeteve të aksidentuara

MIT-ja përmes institucioneve të saj në varësi do të realizojë një platformë "Ueb-Servisi" apo "Modul Elektronik On-line" për evidentimin dhe regjistrimin e automjeteve të përfshira në aksidente rrugore përmes VIN (fotografive dhe dokumentacioneve të tjera të automjeteve)

**Prishtinë, 21 qershor (ER)** - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj. Përmes kësaj marrëveshje do të bëhet regjistrimi i të gjitha veturave të aksidentuara, vendim ky i marrë nga Këshilli për Siguri në Trafikun Rrugor.
MIT-ja përmes institucioneve të saj në varësi do të realizojë një platformë "Ueb-Servisi" apo "Modul Elektronik On-line" për evidentimin dhe regjistrimin e automjeteve të përfshira në aksidente rrugore përmes VIN (fotografive dhe dokumentacioneve të tjera të automjeteve); do të kujdeset për ruajtjen, përdorimin dhe administrimin e shënimeve me qëllim që të bëhet kontrolli i plotë/saktë i automjeteve të aksidentuara, për rikthim në qarkullim rrugor pas riparimit apo ri-aftësimit; do të kujdeset që ta ndalojë rikthimin në qarkullim të automjeteve të dëmtuara në aksidente pa e kryer kontrollin e riparimit apo përmirësimit sipas nenit 27 të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete; do të kujdeset që këtë platformë ta vë në dispozicion të Departamentit për Regjistrim të Automjeteve në Agjencinë e Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme në mënyrë që të eliminohen mundësitë e shmangies së automjeteve të aksidentuara në trafik.
Ministri Lekaj ka theksuar se ministria që drejton me anë të këtij memorandumi tregon vendosmërinë e promovimit të sigurisë në rrugë dhe bashkërenditjen e aktiviteteve në sektorin e sigurisë rrugore si dhe realizimin e qëllimeve të përbashkëta në fushën e sigurisë rrugore.
Ndërkaq drejtori i policisë, Rashit Qalaj, ka theksuar përkushtimin e policisë për t'i përmbushur të gjitha obligimet që dalin nga ligjet e Republikës së Kosovës, për të krijuar trafik të sigurt.



# Oda Amerikane thërret institucionet t'i ndalojnë praktikat jo të drejta afariste

EPOKA E RE A. MAVRAJ




**Prishtinë, 21 qershor** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ua ka rikujtuar institucioneve të Republikës së Kosovës se Kushtetuta parasheh një rend ekonomik i cili bazohet në ekonominë e tregut me konkurrencë të lirë. Sipas Odës Ekonomike Amerikane, një ekonomi funksionale liberale kërkon një terren të barabartë të operimit, ku intervenimi dhe ndërhyrja e qeverisë për rregullimin e forcave të tregut nuk duhet të ekzistojë ose të jetë minimal. "Në këtë aspekt, kontrolli ekskluziv i tregtisë me ndonjë mall a shërbim, është në kundërshtim me orientimin e shtetit për ekonomi të tregut të lirë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës si dhe marrëveshjet e Kosovës me entitetet ndërkombëtare, reflektojnë zotimin e institucioneve të shtetit për përmbushjen e dispozitave përkatëse që promovojnë linjat e një ekonomie të tillë", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

Në këtë drejtim, Oda Amerikane shpreh shqetësimin e saj lidhur me monopolin në homologimin e automjeteve, që pengon konkurrencën, promovon praktikat e padrejta të ofrimit të shërbimeve dhe rrit shpenzimet e bizneseve dhe qytetarëve. "Të pasurit e një operatori të vetëm të homologimit pengon konkurrencën e lirë, rrjedhimisht edhe efikasitetin që do të rezultonte nga ofrimi i shërbimit nga më shumë operatorë si në aspekt të shmangies së çmimeve të larta, por edhe të rritjes së disponueshmërisë së shërbimeve të diversifikuara për publikun. Sistemi aktual i homologimit të automjeteve pengon lirinë e ofrimit të shërbimeve, e cila ka për efekt ndëshkimin e konsumatorëve me shpenzime shtesë logjistike nga marrja e shërbimit në një lokacion të vetëm", thuhet në reagimin e kësaj ode.

Më tej në reagim theksohet se "ngjashëm, dhe për shumë vite, institucionet e shtetit kanë ushtruar trajtim të favorizuar për ndërmarrjet publike përmes implementimit të gabueshëm të dispozitave për blerjet 'brenda shtëpisë', përmes të cilave autoritetet publike blejnë shërbime nga ndërmarrjet publike pa iu nënshtruar procedurave të prokurimit publik, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik. Oda Amerikane përsërit qëndrimin se ndërmarrjet publike në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si 'autoritete publike', meqë Ligji për Ndërmarrjet Publike qartazi parasheh që këto ndërmarrje, pa përjashtim, u nënshtrohen ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore të cilat rregullojnë organizatat e bizneseve private, prandaj blerja e shërbimeve të tyre nga autoritetet kontraktuese përmes 'dispozitave të prokurimit brenda shtëpisë' duhet të ndërpritet meqë cenon konkurrencën e lirë".

Oda Amerikane, gjithashtu, ka rikujtuar periudhën e gjatë prej rreth tre vjetëve kur Komisioni i Konkurrencës ka qenë jo i plotë dhe jofunksional, duke parandaluar në këtë mënyrë Autoritetin e Konkurrencës t'i përmbushë detyrat e tij ligjore në fushën e mbrojtjes së konkurrencës, duke i bërë thirrje qeverisë dhe Kuvendit që ta sigurojnë funksionimin e mirëfilltë të këtij organi gjatë tërë kohës.

Oda Ekonomike Amerikane ka theksuar se pengimi i konkurrencës së lirë përbën shkelje të dispozitave kushtetuese, të cilat në mënyrë eksplicite ndalojnë praktikat që kufizojnë konkurrencën e lirë dhe abuzimin me pozitën dominuese. "Në këtë frymë, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i identifikojnë praktikat e padrejta biznesore dhe ndërmarrin masa për ndalimin e tyre, si dhe të sigurojnë një treg të lirë dhe konkurrues", është thënë ndër të tjera në reagimin e Odës Amerikane.

# Fitimi i 'Z-Mobile'-s nga kontrata me PTK-në është mbi 5 milionë euro

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ



**Prishtinë, 21 qershor** - Anëtarët e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala kanë intervistuar të premten Blerim Devollin, pronar i kompanisë "Dardafon.net L.L.C". Fillimisht Devolli ka kërkuar që intervistimi të bëhej i mbyllur, pa praninë e medieve, por kjo kërkesë e tij nuk arriti të marrë përkrahjen e anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar për PTK-në.

Pronari i operatorit virtual për telefoni mobile "Dardafon.net L.L.C", e njohur si "Z-Mobile", Blerim Devolli, gjatë intervistimit në Komisionin Hetimor Parlamentar për gjendjen në Telekom, ka bërë me dije se më shumë se 200 kërkesa ia kanë dërguar Telekomit që t'i përmbahet kontratës para se ta çonin në Arbitrazh.

Ai ka treguar se për dy vjet e kanë pritur Telekomin para se ta çonin në Arbitrazh.

Devolli ka thënë se vetëm pesë herë Telekomi u është përgjigjur kërkesave të tyre.

Ai ka theksuar se në kompaninë e tij kanë investuar 7 deri në 8 milionë euro.

I pyetur nga kryesuesi i këtij komisioni, Visar Ymeri, për të hyrat financiare, Blerim Devolli ka thënë se i gjithë fitimi i kompanisë "Z-Mobile" nga kontrata me PTK-në është mbi 5 milionë euro. "Për dhjetë vjet 5 milionë e 600 mijë euro. Të hyrat kanë qenë 60 milionë e 437 mijë euro", ka thënë Devolli.

Devolli gjatë intervistimit ka mohuar se ka pasur për qëllim që përmes kësaj kontrate ta dëmtojë Telekomin. Ndërkaq, në fund të intervistimit, Devolli ka kërkuar që të trajtohet si biznesmen, e jo si kriminel. "Ne nuk jemi kriminelë, por jemi biznesmenë dhe kemi të punësuar 1 700 punëtorë, andaj mos na trajtoni të tillë. Gjeni fajtorët për këtë", është shprehur Devolli.

## Më 28 qershor do të mbahet ankandi i nëntë e letrave me vlerë

**Prishtinë, 21 qershor (ER)** - Ministria e Financave ka njoftuar se më 28 qershor do të mbahet ankandi i nëntë me radhë për vitin 2019. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet dyvjeçar në shumën prej 25 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (2 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërën nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", ka njoftuar Ministria e Financave.



# Nismës në Suharekë i bashkohen 222 anëtarë të rinj

SUHAREKË, 21 QERSHOR (ER) - Nismës Socialdemokrate në Suharekë i janë bashkuar 222 anëtarë të rinj të moshave e profileve të ndryshme. Kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, u ka uruar mirëseardhje anëtarëve të ri për të cilët ka theksuar se do ta kenë gjithë hapësirën e nevojshme për ta dhënë kontributin e tyre profesional.
Aderimet e reja, sipas tij, gjithandej vendit te Nisma Socialdemokrate, tregojnë se njerëzit po e vlerësojnë Nismën si adresë të mirëfilltë politike. "Ardhja juaj në Nisma Socialdemokrate do ta fuqizojë edhe më shumë Nismën jo vetëm në Suharekë, por edhe në qendër. Ju keni ardhur në shtëpinë tuaj dhe ne ndihemi më të fuqishëm. Ju siguroj se nuk do t'ju zhgënjejmë", ka thënë Limaj, duke shtuar se Kosovës nuk i duhen parti që rrahin gjoks dhe japin vetëm sharje dhe përplasje. "Kosovës nuk i duhen forca politike të cilat në esencë nuk kanë çka t'i japim vendit, përveç përplasjeve, sharjeve të njëri-tjetrit. Ne kemi besuar që Kosovës duhet t'i japim ide për t'i bashkuar njerëzit me energji pozitive. Ky vizion yni i shprehur në institucionet publike i ka ndihmuar Kosovës. Nisma Socialdemokrate me këtë frymë është kthyer në një urë bashkëpunimi me forcat politike", ka thënë Limaj
Edhe kryetari i Degës së Nisma Socialdemokrate në Suharekë, Sami Hajdaraj, ka thënë se vizioni me të cilin po udhëhiqet Nisma Socialdemokrate po gjen mbështetje në Suharekë dhe në Kosovë. Ditë më parë Nisma ka prezantuar aderime edhe në Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Kaçanik dhe Malishevë.





# Humanisti gjerman nderohet me mirënjohje nga Komuna e Malishevës

MALISHEVË, 21 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur të premten në takim humanistin gjerman Rudolf Broer, të cilit i ka ndarë një mirënjohje për kontributin e dhënë për këtë komunë.
Humanisti Broer në vazhdimësi e ka ndihmuar Komunën e Malishevës, në veçanti sektorin e shëndetësisë. Kryetari Begaj ka thënë se humanisti Broer ka bërë shumë për Malishevën dhe qytetarët e saj. Ndërsa humanisti Rudolf Broer e ka falënderuar Begajn për ndarjen e kësaj mirënjohje. Humanisti Broer ka paralajmëruar sjelljen e donacioneve të tjera për sektorin e shëndetësisë në Komunën e Malishevës. Ai në të kaluarën kishte sjellë mjete konkretizuese për personat me aftësi të veçanta në Shoqatën e "Handikos"-it në Malishevë, një kombibus për bartjen e personave në hemodializë si dhe donacione të tjera.

# Buxheti i Drenasit për vitin 2020 do të jetë mbi 16 milionë euro

DRENAS, 21 QERSHOR (ER) - Komuna e Drenasit ka mbajtur të premten dëgjimin buxhetor me qytetarë, në të cilin është diskutuar për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KFB) në lidhje me projektet prioritare për periudhën 2020-2022.
Në këtë dëgjim publik kanë marrë pjesë, kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, kryesuesi i Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive komunale, kryetarë të fshatrave, asamblistë, përfaqësues nga OSBE-ja, monitorues nga KDI-ja dhe qytetarë.
Gjatë këtij dëgjimi publik është bërë me dije se buxheti i përgjithshëm i Komunës së Drenasit për vitin 2020 do të jetë 16 490 342 euro. "Nga kjo shumë për investime kapitale janë planifikuar mbi 5 420 459 euro. Nëse e bëjmë një krahasim me vitin aktual, buxheti për vitin 2020 do të ketë një rritje prej 8.69 përqindësh", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



# Asgjësohen më shumë se 200 kilogramë mish të prishur në Skenderaj

SKENDERAJ, 21 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se në kuadër të aktiviteteve të Drejtorisë së Inspektoratit, për kontrolle të produkteve ushqimore në marketet dhe dyqanet e kësaj komune, ditë më parë inspektorët e kësaj drejtorie kanë bërë inspektim në një nga qendrat tregtare në qytet, ku kanë gjetur 184 kilogramë mish viçi të prishur në vlerë prej 1 199 eurosh si dhe 43 kilogramë mish pule të prishur. Sipas raportit të inspektorëve, sasia e mishit është gjetur te Qendra Tregtare "Arjeta", nga e cila është sekuestruar dhe është dërguar në vendin e sigurt ku dhe është asgjësuar. "Inspektorati i komunës ka ndërmarrë masa konkrete ndaj rastit në fjalë, duke e gjobitur biznesin konform dispozitave ligjore. Komuna e Skenderajt nuk do të lejojë në asnjë mënyrë që qytetarëve t'u servohen produkte që përbëjnë rrezik për shëndetin e tyre. Për të arritur këtë, kërkohet të bashkëpunohet ngushtë me qytetarët tanë, andaj Komuna e Skenderajt u bënë thirrje të gjithëve të paraqesin tek organet kompetente çdo rast dyshimi të produkteve të prishura ushqimore apo me afat të skaduar", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.



## Fatos Berisha zgjedhet drejtor artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës



PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Fatos Berisha është zgjedhur drejtor artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës (TKK). Sipas njoftimit të TKK-së, Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës, pas një procesi të gjatë vlerësimi, ku të gjithë kandidatët i janë nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë, në mbledhjen e 21 qershorit 2019 ka zgjedhur Fatos Berishën drejtor të ri artistik. Ai do ta udhëheqë mbarëvajtjen e punëve artistike dhe kreative në Teatrin Kombëtar të Kosovës për katër vjetët e ardhshëm. Sipas tyre, kandidati Fatos Berisha i ka plotësuar të gjitha kriteret juridike dhe profesionale për ta ushtruar detyrën e drejtorit artistik të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

# NË RASTIN E KOSOVËS EDHE SHKATËRRIMET JANË DËSHMI E QËLLIMIT TË SERBISË PËR GJENOCID



Bardhyl MAHMUTI

Një nga çështjet më delikate për të argumentuar se në një kontekst të caktuar ka ndodhur gjenocid lidhet me dëshmitë se vrasjet, dhunimet, dëbimet kanë pasur për qëllim shkatërrimin e tërësishëm ose të pjesshëm të njërit nga grupet e mbrojtura me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit. Jurisprudenca e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ruandën dhe e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë na mundësojmë të nxjerrim konkluzione për qëllimin gjenocidar edhe në situatat kur të akuzuarit refuzojnë të pranojnë se kanë kryer krimin me qëllim që të shkatërrohet një grup i caktuar kombëtar, etnik, racor ose fetar si i tillë. Kështu për shembull Dhoma e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ruandën në procesin kundër Jean-Paul-Akayesu thekson: "Kur kemi të bëjmë me atë se si të përcaktohet qëllimi specifik i atij që ka kryer këtë krim, Dhoma konsideron se qëllimi është faktor i natyrës psikologjike të cilin është shumë e vështirë, madje e pamundur, ta përthekojmë. Për këtë arsye, në mungesë të pranimit nga ana e të akuzuarit, qëllimi i tij mund të nxirret nga një numër faktesh. Për shembull, Dhoma vlerëson se është i mundshëm të nxirret qëllimi i gjenocidit duke e mbështetur një akt të veçantë për të cilin është akuzuar në tërësinë e akteve dhe thënieve të së akuzuarit, ose nga konteksti i përgjithshëm i kryerjes së akteve tjera të dënueshme, të drejtuara në mënyrë sistematike kundër të njëjtit grup, të kryera qoftë nga i njëjti person ose nga persona të tjerë. Faktorë tjerë, si shkalla e armiqësive të kryera, karakteri i tyre i përgjithshëm në një rajon ose vend, apo fakti i zgjedhjes së qëllimshme dhe sistematike i viktimave për shkak të përkatësisë së tyre një grupi të veçantë, duke i veçuar anëtarët e grupeve tjera, i mundësojnë dhomës që të nxjerrë qëllimin për gjenocid (Tribunal Pénal International, LE PROCUREUR CONTRE JEAN-PAUL-AKAYESU, Affaire N° ICTR-96-4-T, paragrafi 523). Një element tjetër me rëndësi del nga jurisprudenca Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë lidhur me atë që shpesh futet në kuadër të "dëmeve materiale". Shkatërrimi ose përvetësimi i të mirave material gjatë një konflikti të armatosur, sulmi apo bombardimi i qyteteve, i fshatrave, i banesave apo i ndërtesave të pambrojtura, e që nuk janë caqe ushtarake, konsiderohet shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1948 (neni 147 i këtyre konventave) dhe hyjnë në kategorinë e krimeve të rënda të luftës. Të njëjtat qëndrime janë të përfshira edhe në statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ruandën (neni 4), në statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish- Jugosllavinë (neni 2) dhe në statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare ( neni 8). Mirëpo në procesin gjyqësor kundër Radisllav Kërstiqit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë thuhet: "Dhoma e Shkallës së Parë thekson se shkatërrimi fizik ose biologjik i grupit shpesh shoqërohet me cenimin e të mirave dhe simboleve kulturore dhe fetare të grupit që është marrë në shënjestër, cenim që në mënyrë legjitime mund të llogaritet gjatë argumentimit për të dëshmuar ekzistencën e qëllimit për shkatërrimin fizik të grupit. Dhoma konsideron që në këtë rast shkatërrimi i qëllimshëm i xhamive dhe i shtëpive që u takojnë anëtarëve të grupit është dëshmi e qëllimit për të shkatërruar grupin" (Tribunal Penal International pour Ex-Yougoslavie, La Chambre de Première Instance, Le procureur contre Radislav Krsti?, Affaire nr. IT-98-33-T, 2 août 2001, paragrafi 580). Duke u mbështetur në këtë interpretim juridik të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë mund të nxjerrim si konkluzion se shkatërrimi i 100.589 shtëpive, i 358 shkollave, i 30 shtëpive kulturore, i 93 bibliotekave, i 123 institucioneve shëndetësore dhe i 220 objekteve të kultit fetar (215 xhami, teqe, tyrbe dhe 5 kisha katolike) janë dëshmi për qëllimin e Serbisë për të shkatërruar shqiptarin si të tillë.

# Ura e Balincës lëshohet për qarkullim, fillon puna në transitin e Malishevës



PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të premten ka përuruar urën e Balincës, pjesë e rrugës nacionale N9, Prishtinë - Pejë. Vlera totale e investimit që përfshinë ndërtimin e urës me gjithë infrastrukturën përcjellëse kap shifrën 773 485 euro. Po ashtu, Lekaj ka marrë pjesë të premten edhe në fillimin e punimeve në segmentin e ri të transitit të Malishevës.
Loti me gjatësi prej 3.6 kilometrash do të kushtojë rreth 960 mijë euro dhe pritet të përfundojë për 180 ditë pune. Ministri Lekaj ka thënë se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit nën udhëheqjen e tij është e përkushtuar të kryejë projekte të rëndësishme infrastrukturore, lokale e qendrore, të nevojshme për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

## Alush Musaj rizgjedhet rektor në Universitetin 'Isa Boletini'



Mitrovicë, 21 qershor (ER) - Këshilli i Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" të premten ka zgjedhur rektorin e këtij universiteti. Me nëntë vota për të këtij këshilli, Alush Musaj është rizgjedhur në pozitën e rektorit të Universitetit "Isa Boletini". Për Musajn kanë votuar të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, ndërkaq tre kandidatët e tjerë nuk kanë marrë asnjë votë. Në garën për rektor kanë qenë edhe Islam Fejza, Blerim Baruti dhe Qazim Tmava.

## Boltoni në Izrael, në kohën e tensioneve me Iranin



UASHINGTON, 21 QERSHOR - Këshilltari për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Bolton, do të udhëtojë në Izrael në fundjavë për të biseduar rreth sigurisë rajonale me zyrtarët rusë dhe izraelitë.
Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Garrett Marquis, tha se Boltoni do të takojë kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, ndërsa më pas do të zhvillojë bisedime me homologun e tij izraelit, Meir Ben-Shabbat, dhe atë rus, Nikolai Patrushev.
Takimet do të zhvillohen në kohën e tensioneve në rritje midis Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, sidomos pas rrëzimit të një droni amerikan nga Teherani, të enjten.
Teherani tha se droni ka fluturuar mbi territorin e tij, ndërsa Uashingtoni tha se ai ka qenë mbi ujërat ndërkombëtarë.
Në vazhdën e këtyre zhvillimeve, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se ka urdhëruar sulme ushtarake në Iran, porse më pas i ka anuluar ato nga shqetësimet për viktimat.

# Trumpi konfirmon se ShBA-ja ishte gati për goditje ndaj Iranit

Presidenti amerikan Donald Trump tha se plani kishte qenë për t'i goditur tri objektiva të ndryshme në përgjigje të rrëzimit të dronit dhe se i kishin thënë se 150 veta do ta kishin humbur jetën si pasojë e tyre dhe për këtë arsye ai ishte tërhequr



UASHINGTON, 21 QERSHOR - Presidenti amerikan Donald Trump tha të premten se kishte hequr dorë nga një goditje ushtarake ndaj Iranit sepse një përgjigje e tillë ndaj rrëzimit të dronit amerikan nga ana e Teheranit do të shkaktonte humbjen e jetës së një numri të madh njerëzish. Media amerikane kishte njoftuar se presidenti amerikan Donald Trump miratoi goditje ajrore ndaj Iranit të enjten, por më pas u tërhoq nga vendimi për t'i ndërmarrë ato.
Në një sërë postimesh në Twitter, presidenti Trump tha se sanksionet ekonomike ndaj Iranit, po jepnin efekt dhe sanksione të tjera ishin vendosur të enjten vonë, pas shkatërrimit të dronit amerikan nga një raketë iraniane tokë-ajër. Trumpi tha se plani kishte qenë për të goditur tre objektiva të ndryshme në përgjigje të rrëzimit të dronit dhe se i kishin thënë se 150 vetë do të kishin humbur jetën si pasojë e tyre dhe për këtë arsye ai ishte tërhequr.
Agjencia e lajmeve Reuters thotë se Qeveria iraniane i tha se kishte marrë një mesazh nga presidenti Trump përmes Omanit, ku ai paralajmëronte për një sulm të pritshëm ndaj Iranit.
Reuters tha se përgjigjja e menjëhershme e Teheranit ndaj mesazhit të presidentit Trump ishte një paralajmërim i ashpër lidhur me pasojat "rajonale dhe ndërkombëtare" nëse Shtetet e Bashkuara ndërmerrnin veprime ushtarake.
Por një zyrtar iranian më pas mohoi që Irani të kishte marrë mesazh paralajmërimi.
I dërguari amerikan për Iranin Brian Hook, i cili ishte për vizitë në Arabinë Saudite tha se është e rëndësishme të bëhet gjithçka për të qetësuar gjendjen.
"Diplomacia jonë nuk i jep të drejtën Iranit që të përgjigjet me forcë ushtarake dhe Irani duhet t'i përgjigjet diplomacisë sonë me diplomaci, jo forcë ushtarake", tha ai.
Por kreu i Divizionit të Hapësirës Ajrore të Gardës Revolucionare iraniane, admirali Hajizadeh tha se Teherani kishte dërguar dy sinjale paralajmëruese 10 minuta para se të lëshohej raketa. "Ata që kontrollonin dronin, i dëgjuan paralajmërimet por nuk u kushtuan vëmendje. Duke pasur parasysh se droni kishte shkelur kufijtë tanë, ai u vu në shënjestër nga raketa tokë-ajër e divizionit ajror të Gardës Revolucionare dhe u godit", tha ai.
Por Uashingtoni këmbëngul se droni ishte mbi ujra ndërkombëtare.
Vendimi amerikan për t'u tërhequr nga goditjet ushtarake ndaj Iranit, duket se shmangu një konflikt të mundshëm të armatosur që do të përfshinte pjesën më të madhe të Lindjes së Mesme.
Po ashtu duket se hap një shteg për dialog mes dy vendeve kundërshtare.
Të enjten në mbrëmje, Administrata Federale e Aviacionit lëshoi një urdhër urgjent përmes së cilit ndalonte të gjitha kompanitë ajrore amerikane që të lejonin avionë të hynin në hapësirën ajrore mbi pjesë të Gjirit Persik dhe atij të Omanit, zona ku u godit droni i Marinës amerikane nga Irani.
Edhe disa linja ajrore ndërkombëtare, përfshirë KLM-në holandeze dhe Qantas të Australisë thonë se nuk do të fluturojnë mbi Ngushticën e Hormuzit.

## Moska reagon pas protestës anti-ruse në Gjeorgji


Reuters

MOSKË, 21 QERSHOR - Presidentja e Gjeorgjisë e quajti Rusinë "armik dhe pushtues" dhe pohoi se Moska kishte ndihmuar në nxitjen e protestave që tronditën Tbilisin. Por të premten Kremlini fajësoi politikanët radikalë gjeorgjianë për atë që e quajti një provokim anti-rus.
Deklarata e fortë e presidentes Salome Zurabishvili vjen pas skenave të dhunshme në kryeqytetin gjeorgjian, ku të enjten vonë në mbrëmje policia përdori gazin lotsjellës e plumba gome për të ndalur turma të zemëruara njerëzish të hynin në parlament për shkak të vizitës së një ligjvënësi rus. Qindra vetë, si protestues dhe policë, u plagosën gjatë përleshjeve, disa prej tyre morën dëmtime të rënda. Protestuesit u përpoqën të thyejnë kordonin policor, ata hodhën shishe e gurë ndaj policëve, duke marrë një përgjigje të ashpër.
Kryetari i Parlamentit gjeorgjian Irakli Kobakhidze dha dorëheqjen të premten, duke përmbushur një nga kërkesat e protestuesve. "Rusia është armiku dhe pushtuesi ynë. 'Kolona e pestë' që ajo kontrollon mund të jetë më e rrezikshme se agresioni i hapur" shkruante në një postim në "Facebook" pas trazirave presidenti Zurabishvili. "Vetëm Rusia përfiton nga një ndarje e vendit, e shoqërisë si dhe konfrontimi i brendshëm dhe kjo është arma më e fuqishme sot", shkruante ai.
Ndikimi i Rusisë në Gjeorgji mbetet një çështje e ndjeshme politike.
Opozita akuzon partinë në pushtet, e cila mbështeti Salome Zurabishvili për garën presidenciale të zhvilluar në fund të vitit të kaluar, se po tregohet shumë e butë përballë Moskës. Në vitin 2008, ky shtet i vogël i Kaukazit Jugor, aleat i ShBA-së, humbi një luftë të shkurtër kundër Rusisë.
Të dy vendet nuk kanë marrëdhënie diplomatike që prej asaj kohe. Rusia njohu pavarësinë e dy rajoneve të shkëputura gjeorgjiane, Osetisë Jugore dhe Abkazisë, ku tashmë janë dislokuar trupa ruse.

# 22 qershori i '98-s ishte ditë e kobshme për familjen Zogjani nga Halilaqi

E hëna e datës 22 qershor e vitit 1998 do të jetë dita më enigmatike dhe më e kobshme për familjen Zogjani nga Halilaqi i Fushë-Kosovës. Atë pasdite Hyseni, që ishte me vendbanim në lagjen "Dardania" në Prishtinë, kishte dalë për të blerë perime e gjësende të tjera për familjen, por nuk u kthye kurrë më në shtëpinë tonë dhe në mesin tonë.

Hyseni lindi më 10 mars të vitit 1957 në Halilaq të Fushë-Kosovës. Ishte një ndër fëmijët e parë (Hyseni ishte binjak me vëllanë, Ademin), të prindërve Ahmetit dhe Zojës, që me punë dhe sakrifica kishin rritur t'i rritnin shëndetshëm dhjetë fëmijë. Shkollimin fillor e mbaroi në fshatin e lindjes, të mesmen në Prishtinë, ndërsa studioi në Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë.



Në vitet 1974-1975, kur Hyseni ishte i ri në moshë, kulla dykatëshe mes malit në Halilaq vizitohej shpesh nga dajallarët Azem dhe Gani Sylaj.

Ishte normale që dajallarët ta vizitojnë hallën, por këto frekuentime të dajallarëve në orët të vona të natës, pëshpërimat mes tyre dhe prindërve dhe kujdesin që tregonte e ëma kur përcillte nipat që i ngjiteshin malit, e bënë kureshtar djaloshin që ishte në formim e sipër. Iu zgjua shpejt kureshtja se çfarë fshihte nënë Zoja në arkën poshtë pajës së nusërisë dhe gradualisht fitoi besimin e dajallarëve për t'i lexuar librat "e ndaluar" dhe fletushkat që ndërroheshin herë pas here poshtë arkës.

Hyseni po kuptonte gjithnjë e më shumë për ndarjen e kombit shqiptar në disa shtete, për dhunën dhe padrejtësitë që i bëheshin popullit shqiptar të Kosovës dhe atyre në pjesë të tjera të Jugosllavisë së asaj kohe. Ai mësoi shpejt se dajallarët e tij me shumë shokë të tjerë po vazhdonin një veprimtari që s'ishte ndalur kurrë në shumë gjenerata, të një lufte të fshehtë për vetëdijesimin e bashkëkombësve për gjendjen e rëndë në të cilën ishin shqiptarët në këtë shtet që quhej Jugosllavi. Ai përqafoi shpejt idenë për liri e vetëvendosje për shqiptarët dhe të njëjta filloi t'i shpërndajë te shokët dhe moshatarët e tij.

Urrejtja ndaj regjimit iu shtua edhe më shumë kur dajallarët e tij me shumë shokë, miq e dhëndurë u arrestuan nga regjimi. Mori pjesë aktive në demonstratat e vitit 1981 dhe ishte në përpjekje të vazhdueshme për t'i gjetur lidhjet e shkëputura të atdhetarëve, që në masën më të madhe tashmë gjendeshin në burg. Me pasionin për muzikën dhe dashurinë për Shqipërinë, Radio Tirana ishte gjithmonë e hapur dhe këngët, radiodokumentarët e komentet për Kosovën incizoheshin të gjitha në shirit. Fryma e atdhedashurisë dhe urrejtjes për armikun po rritej gjithnjë e më shumë te të gjithë anëtarët e familjes.

I brumosur me dashurinë për shtetin amë, Shqipërinë, që në mundësinë e parë, pas hapjes së kufijve në vitin 1990, Hyseni e vizitoi shpejt atë.

Zhgënjimin që kishte përjetuar për vendin që e mendonte si parajsë me lule, e mbylli thellë në zemrën e tij dhe nuk e shprehte me të tjerët, duke mos dashur t'i zbehë shpresat se Shqipëria do t'i dilte zot Kosovës.

Vizitat e tij në Shqipëri u shpeshtuan në pesëvjeçarin e dytë të vitit '90. Ato tani nuk kishin për qëllim eksplorimin e bukurive natyrore të Shqipërisë dhe as shuarjen e kureshtjes për ta njohur më mirë vendin e ëndrrave të tij.



Hyseni tashmë i ishte futur një pune tjetër shumë serioze dhe shumë të rrezikshme. Ai tashmë bënte pjesë në guerilen shqiptare që kishte filluar aksionet sporadike mbi postbllоqet e policisë serbe. Shokët duheshin takuar, planet duheshin bërë mirë, vëmendja e kujdesi duhej të ishin në nivel shumë të lartë, ndërkohë që rreziku ishte gjithnjë e më i madh. Me dhjetëra herë, ilegalisht, kaloi kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë. Armët duheshin bartur vetë dhe rrugët ishin shumë të vështira. Përpjekjet po bëheshin të vështira, konspiracioni duhej të ishte i thellë.

Armiqtë kishin depërtuar në çdo pore të jetës dhe po i ndiqnin këmba-këmbës. Shokët po vriteshin dhe arrestoheshin çdo ditë. Nait Hasani, Xhavit Haziri e Hafir Shala ishin arrestuar.

Rënia e Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës e lëndoi shumë. Xheladin Gashi (Komandant Plaku), me të cilin ishte jashtëzakonisht i afërt, shpëtoi për pak nga arrestimi dhe kaloi në ilegalitet të plotë. Banesa e Hysenit në Dardani që prej vitesh ishte bërë çerdhe gueriles, ishte dekonspiruar dhe shokët duhet të kërkonin vendstrehim tjetër. Hyseni po ndiqej këmba-këmbës andaj as atë vetë nuk po e zinte më nata në banesën e tij. Kështu, atë pasdite qershori Hyseni, i veshur thjesht e me makinën e tipit "Golf", doli për të bërë shpejt pazaret ditore, me shpresën se do të kthehej për ta kaluar mbrëmjen me katër fëmijët e vet, që po rriteshin të lumtur, pa ditur çfarë mund të sillte jeta. Por, ai nuk u kthye më kurrë dhe familja mbeti me ankthin e pritjes dhe mallin e pashuar për të.



Gjashtë muaj më vonë u arrestua edhe vëllai i tij i vogël, Arsimi, i cili kishte ndjekur rrugën e të vëllait. Arrestimi i tij ndodhi në një autobus lokal derisa ishte në një detyrë shumë të rëndësishme ngarkuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Pas katër muajve burg të rëndë, plot maltretime fizike e psikike, Arsimi u vra në Burgun e Dubravës.

Më 12 prill të vitit 1999 nga paramilitarët serbë u vra edhe babai i tyre, Ahmeti. Ai u gjet i varrosur në varrezat e fshatit Vragoli, ndërsa Arsimi u gjet i varrosur në fshatin Rakosh të Istogut. Tre muaj pas çlirimit, në një ceremoni të përbashkët, u rivarrosën të dy në fshatin e lindjes.

E rrallë

# Thyen rekord, 103-vjeçarja hyn në historinë e maratonës së vrapit



Sporti me të vërtetë ndihmon për të jetuar më gjatë. Julia Hurricane Hawkins 103-vjeçare është një shembull për këtë. Ajo është gruaja më e vjetër që konkurroi dhe vendosi një rekord të ri në garën 50 metra. Në fakt, në Lojërat Kombëtare në Albuquerque, New Mexico, konkurrohej në kategorinë "Gratë mbi 100 vjeç", por me dëshirën e saj për t'u përfshirë dhe për të konkurruar, Julia Hawkins është bërë sportistja më e vjetër në vrap.

FOTO E DITES



Një kamion i stërmbushur me plot njerëz shihet në Nigeri. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Shoferët e BMW-së marrin më së shumti dënime në trafik



Shoferët e makinave BMW ka më shumë mundësi të marrin dënime për shkeljen e rregullave të trafikut. Një studim i realizuar nga "Money Super Market", ka analizuar mbi gjashtë milionë dënime gjatë pesë vjetëve të kaluara. Këto dënime përfshinin vozitjen e shpejtë, vozitjen në gjendje të dehur, kalimin kur është semafori i kuq dhe aksidente të tjera.

## BARSOLETA E DITËS



**Një ditë mësuesja, duke i përfunduar notat, e pyet Agimin:**
**- Sa bëjnë 2+2?**
**Agimi: Katër, mësuese.**
**Mësuesja: Ulu Agim, pesëshe.**
**Agimi: E dita që bëjnë pesë, por u habita, mësuese.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)**

### "THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val







**Ne ora 18:00**

### "X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
**Regjia:** Simon Kinberg

**Në ora 20:00**

### "MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
**Regjia:** F. Gary Gray







**Ne ora 22:00**

### "M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

**Regjia:** Tate Taylor

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Sot duket që nuk jeni ngritur me humor të mirë sepse do të kapeni me këdo që ju qëndron pranë. Priten debate gjatë gjithë ditës.



**DEMI** Po korrni frytet e asaj çfarë keni mbjellë në të shkuarën. Keni qenë mjaft skrupoloz në gjërat që keni vendosur të bëni dhe kjo ju ka zgjidhur punë.



**BINJAKËT** Racional dhe mjaft i ftohtë në mendime, sot do të jeni udhërrëfyes për shumë nga miqtë tuaj të cilët do t'ju kërkojnë këshilla.



**GAFORRJA** Keni rënë pre e rutinës kohët e fundit dhe kjo gjë po ju dëmton sepse nuk doni të dilni ose nuk po gjeni motivin për të dalë prej saj.



**LUANI** Po merreni me një investim tuajin tek i cili besoni pavarësisht prej skepticizmit të partnerit. Jeni gjithë kohën i zënë me këtë prioritet.



**VIRGJËRESHA** Sot ndiheni i qetë dhe i plotësuar në lidhjen në çift. Do të bëni një udhëtim që do t'jua kujtojë kohët e shkuara.



**PESHORJA** Sot do të bini pre e nostal-gjisë dhe gjithë dita do t'ju shkojë mes kuj-timeve. Nuk po shihni diçka konkrete për të ardhmen tuaj.



**AKREPI** Po vini në praktikë gjithçka që keni krijuar lidhur me një ngjarje të caktuar sot. Jeni mjaft i përkushtuar që gjërat të dalin mirë.



**SHIGJETARI** Sot jeni në mëdyshje ta besoni logjikën apo intuitën tuaj. Keni prova që intuita s'ju ka lënë në baltë, por dhe duhet të logjikoni mbi vendimet që merrni.



**BRICJAPI** Besojini perceptimit tuaj sepse do t'ju udhëheqë pikërisht aty ku doni të arrini. Dita do të mbyllet me një lajm të gëzueshëm.



**UJORI** Nuk ndiheni mirë nga ana emocionale në këtë periudhë. Ndieni mungesën e dikujt dhe do ta kompensoni duke harxhuar për blerje.



**PESHQIT** Një ditë e dedikuar vetëm për çështjet e biznesit. Jeni i fiksuar te detajet e një marrëveshjeje që do të thotë shumë për ju.

# Ish i dashuri i Bellas frikësohet për fotografitë e veta nudo




Mod Sun ka filluar të shqetësohet për fotografitë personale pasi ish e dashura e tij, Bella Thorne, i zbuloi të sajat kur një haker u përpoq ta zhvaste. "Nëse telefoni i saj është hakuar, jam disi i frikësuar që 'të palarat' e mia do të përfundojnë online. Për fat të mirë më është thënë se organin gjenital e kam të mrekullueshëm, por Whoopi Goldberg ka folur shumëçka. Nuk do të dërgoj më fotografi të çmendura", ka thënë reperi 32-vjeçar për "TMZ".

# Gigi Hadid vesh kostum të pikturuar



Gigi Hadidi ka prezantuar një kostum të vizatuar me një vepër arti. 23-vjeçarja kishte veshur një kostum të koleksionit të Heron Preston pranverë-verë 2020 në Londër. Kostumi ishte i bardhë, i spërkatur me ngjyra, duke e kombinuar me aksesorë të thjeshtë.



# Rita publikon 'Ritual'

Rita Ora ka publikuar këngën më të re në bashkëpunim me Tiesto dhe Jonas Blue. "Ishim gjithë bekim gjatë punës në këtë projekt arti për ju dhe shpresoj se do ta doni më shumë se unë", ka shkruar Rita në "Instagram", ku ka njoftuar për publikimin e kësaj kënge. Këngëtarja jonë paraqitet me dukje tejet tërheqëse, me flokët bionde dhe veshje të thjeshtë, por që i vënë në dukje format trupore për t'u lakmuar.

# Humb jetën muzikanti i njohur



Bota e muzikës është shokuar nga një ngjarje e rëndë. Muzikanti i famshëm, Philippe Cerboneschi (i njohur gjithashtu si "Zdar"), ka humbur jetën aksidentalisht në Paris. Lajmin e hidhur e ka konfirmuar menaxheri i tij, ndërsa mediat raportojnë se ai ka rënë nga një ndërtesë e lartë duke gjetur vdekjen e menjëhershme. Cerboneschi ishte 50 vjeç.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi Servisimi Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Njomza Emini: Ditë e veçantë për lëvizjen paraolimpike

Në Vushtrri është mbajtur 'MiniOlimpiada 2019', kurse presidentja e Komitetit ParaOlimpik të Kosovës, Njomza Emini, ka vlerësuar ditën e premte si të veçantë për lëvizjen paraolimpike. "Për lëvizjen paraolimpike në Kosovë është ditë e veçantë. Në këtë mjedis, mes shumë mbështetësve dhe njerëzve që na përkrahën në çastet më të vështira, jemi gati ta tregojmë potencialin dhe fuqinë që e ka komuniteti i paraolimpizmit në Kosovë. Në Minsk hapen lojërat e dyta evropiane, paralelisht vazhdohet tradita edhe në Kosovë, për MiniOlimpiadën që do t'i sjellë garat interesante në disiplina të ndryshme", ka thënë Emini




'Epoka e re'

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Komiteti Paraolimpik i Kosovës në ambientet e Akademisë për Siguri Publike në Vushtrri ka organizuar aktivitetin tradicional "MiniOlimpiada 2019", i cili është organizuar në partneritet me OPFAKOS dhe me mbështetjen e MKRS-së, UNICEF-it, OSBE-s, KFOR-it, Akademisë për Siguri Publike, Kryqit të Kuq dhe Handikos-it.
Pjesë e këtij aktiviteti ishin dhe dy krerët e institucioneve të Kosovës, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj, të cilët i dhanë mbështetje këtij komuniteti. Kryetari i Kuvendit ka thënë se ardhja këtu dëshmon për përkrahjen ndaj kësaj kategorie, ndërsa i ka ftuar që dhe këta të marrin përgjegjësi në institucione. "Do t'u japim mundësi dhe shanse të gjithëve juve. Pres që nga ju në garat paraolimpike të jeni kampionë jo vetëm në Kosovë, por edhe në botë", ka thënë Veseli.
Ndërkaq, i pari i ekzekutivit, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se kanë bërë disa punë të mira për këtë komunitet dhe ka theksuar se nuk do të ndalen së mbështeturi në të gjitha fushat.
Ministrja e Pushtetit Lokal, Adriana Hodziq, u shpreh se të gjithë duhet të angazhohen që personat me nevoja të veçanta të kenë qasje si të gjithë qytetarët e tjerë të Kosovës. Ndërsa presidentja e Komitetit Paraolimpik të Kosovë, Njomza Emini, ka thënë se sot është një ditë e veçantë për lëvizjen paraolimpike në Kosovë, pasi vazhdohet tradita e organizimit të MiniOlimpiadës. "Për lëvizjen paraolimpike në Kosovë është ditë e veçantë. Në këtë mjedis, mes shumë mbështetësve dhe njerëzve që na përkrahën në çastet më të vështira, jemi gati të tregojmë potencialin dhe fuqinë që e ka komuniteti i paraolimpizmit në Kosovë. Në Minsk hapen lojërat e dyta evropiane, paralelisht vazhdohet tradita edhe në Kosovë, për MiniOlimpiadën që do t'i sjellë garat interesante në disiplina të ndryshme", ka thënë Njomza Emini. "Kosova dhe të rinjtë tanë kanë kapacitet shumë më të madh, dëshirë të pafund për t'i bërë krenarë familjet e tyre, shoqërinë dhe vendin tonë. Komiteti Paraolimpik dita-ditës po merr fizionominë e një organizate të respektuar në vend, e gatshme për t'iu shërbyer federatave të sporteve paraolimpike dhe klubeve. Misionit tonë, në pozitën e sekretarit të përgjithshëm, i është bashkuar edhe Afrim Maliqi nga Handikosi, kontributi i të cilit do të jetë vlerë e shtuar për lëvizjen tonë.
Numri i sportistëve po shënon rritje dita-ditës, bashkë me të edhe numri i klubeve dhe federatave që japin një sinjal të mirë për Komitetin Paraolimpik dhe ambiciet tona. Tashmë puna, përkushtimi dhe arritjet tona nuk do të mbesin vetëm në kufijtë e Kosovës. Sukseset tuaja do të na dërgojnë para sfidave ndërkombëtare. Atë që bëri Majlinda, Nora, Distria, Akili, Donjeta… atë sukses dhe ato të arritura i shoh si mundësi në secilin prej jush në lëvizjen paraolimpike", ka shtuar ajo.
Njomza Emini ka vlerësuar se në këtë rrugëtim të vështirë, Komiteti Paraolimpik i Kosovës ka pasur mbështetjen e pakursyer të miqve dhe njerëzve të vullnetit të mirë, kontributi i të cilëve ka qenë i jashtëzakonshëm në misionin për t'i promovuar vlerat e paraolimpizmit në Kosovë. Emini ka falënderuar presidentin e KOK-ut, Besim Hasani, drejtorin e Departamentit të Sportit, Ibër Alaj, OSBE-në, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, KFOR-in, Kryqin e Kuq të Kosovës, Handikosin dhe organizatën OPFAKOS. Ndërsa një falënderim Emini pati për ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Sllovakisë, Miroslav Lajcak, i cili, në cilësinë e kryesuesit të misionit të OSBE-së, dha mbështetjen konkrete për Komitetin Paraolimpik të Kosovës, duke ndarë shumën prej 10 000 eurosh për këtë ngjarje. Për këtë merita ka edhe zyra sllovake në Prishtinë dhe Rastislav Kostilnik.

## SHKURT

### Kosova 'fluturon' në ranglistën e UEFA-s

Kosova ka bërë një ngritje në ranglistën e UEFA-s sa i përket progresit të Federatave Kombëtare. Në fakt, në kuadër të UEFA-s ekziston trofeu "Maurice Burlaz", çmim që i jepet Federatës kombëtare që ka arritur rezultatet më të mira në garat e të rinjve të UEFA-s gjatë dy sezoneve të mëparshme për U17 dhe U19. Ky trofe është emëruar sipas Maurice Burlaz, ish-nënkryetare e Komitetit Rinor të UEFA-s. Në edicionin 2016/17, Kosova ishte në vendin e 55-të (të fundit në ranglistë), kurse tani është në vendin e 43-të, duke përparuar kësisoj për 12 pozita. Në aspektin e përparimit Kosova është në vendin e 4-t prej Federatave që kanë përparuar më së shumti gjatë periudhës dyvjeçare.

### Drita prezanton Namanin

Skuadra e Dritës nga Gjilani nuk ka të ndalur dhe duket se do të jetë kandidate serioze për titullin e kampiones në Superligë. Vetëm një ditë pas e prezantoi Ilir Blakçorin, skuadra nga Gjilani e prezantoi edhe një ish-lojtar të skuadrës së Llapit. Fjala është për Hamdi Namanin, i cili për shumë vite ishte kapiten i Llapit. Namani vlerësohet si ndër mesfushorët më të mirë në Kosovës.

### Haxhihamza vazhdon me Gjilanin, largohet Kaçiu

Skuadra e Gjilanit që siguroi mbetjen në Superligë vetëm nëpërmjet ndeshjes se barazhit, ka njoftuar se ka arritur që të vazhdoi bashkëpunimin me portierin Kenan Haxhihamza. 22-vjeçari nga Rahoveci, ka arritur marrëveshje me klubin, që edhe në edicionin e ardhshëm garues të jetë pjesë e klubit kuq e bardhë. "Vlen të theksohet se bordi drejtues i klubit, po punon me ritme të larta për afrimin e futbollistëve të tjerë dhe ditëve në vijim pritet zyrtarizimi i tyre", thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit. Ndërsa portieri tjetër, Donat Kaçiu e ka zyrtarizuar largimin nga kjo skuadër. "Përmes këtij publikimi dua të ju njoftoj që kam ndarë rrugët me Gjilanin pas tri vitesh e gjysmë bashkëpunimi dhe tani jam futbollistë i lirë", ka thënë Kaçiu.

### Prishtina licencon 25 futbollistë për UEFA, por mungojnë Januzi dhe Bardhoku

FC Prishtina ka licencuar 25 futbollistë për raundin paraeliminator kundër St Joseph's të Gjibraltarit, ndeshje që zhvillohet të enjten më 27 qershor nga ora 20:45 dhe ndeshja kthyese më 2 korrik në Gjibraltar. Klubi kryeqytetas njofton se nuk janë licencuar Ahmed Januzi dhe Tun Bardhoku përshkak se nuk i kanë liruar ish-klubet e tyre.
Dy futbollistët do të kenë të drejt loje për raundin e parë kundër Rangers nëse kualifikohet Prishtina. Skuadra bardhekaltër ka falënderuar për konstruktivitet klubet e Drenicës, Dritës dhe Flamurtarit.

## Arsenali shmang largimin e Xhakës me emërimin kapiten



LONDËR, 21 QERSHOR - Arsenali bën një lëvizje të papritur për ta shmangur largimin e Granit Xhakës drejt Atleticos së Madridit. Klubi londinez po planifikon ta bëjë mesfushorin shqiptar kapiten të ri të "Topçinjve". Xhaka u bashkua me Arsenalin në 2016-n dhe që atëherë ka seleksionuar 130 paraqitje pas një fillimi të vështirë të jetës në veri të Londrës. Atij iu desh pak kohë ta fitonte përkrahjen e tifozëve. Sipas "Daily Star", drejtuesit e Atletico Madridit e konsiderojnë Xhakën futbollistin ideal për zëvendësimin e Rodrit, që është shumë pranë largimit drejt Manchester Cityt. Për të mos lejuar largimin e Xhakës, Arsenali po ecën përpara me planin për ta bërë kapiten mesfushorin, pasi Laurent Koscielny, i cili po hyn në vitet e fundit të karrierës, do ta dorëzojë shiritin.

# FFK-ja: Të ndërpriten urgjentisht ndeshjet ilegale në Kosovë




PRISHTINË, 21 QERSHOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka reaguar ashpër ndaj ndeshjeve ilegale në futboll dhe improvizimit të garave në territorin e Republikës së Kosovës nga struktura ilegale në veri të vendit. FFK-ja iu bënë me dije të gjithëve se ky është një mashtrim, njëherësh nxitje e problemeve për popullatën në veri të vendit, ngaqë improvizime të tilla më nuk do të lejohen. "Ditë më parë në mediat serbe bëri bujë lajmi për inkuadrimin e të ashtuquajturit 'FK Trepça' nga Mitrovica e Veriut në një rang më të lartë të garave nën ombrellën e Federatës së Futbollit të Serbisë. FFK-ja bën me dije se në institucionet shtetërore dhe sportive të Republikës së Kosovës janë të regjistruara KF 'Trepça '89', që bën gara në Superligën e Kosovës dhe KF 'Trepça', që bën gara në Ligën e Parë të Kosovës dhe ato janë klubet e vetme legjitime me këtë emër", thuhet në reagimin e FFK-së.

Federata e Futbollit të Kosovës e konsideron ilegal çdo aktivitet të klubeve të paregjistruara në institucionet e shtetit dhe organet e saj dhe kërkon ndërprerjen e menjëhershme të këtyre aktiviteteve të cilat në masë të madhe e dëmtojnë imazhin e FFK-së dhe të vet shtetit. "FFK-ja do ta shqyrtojë këtë çështje me organet e UEFA-s dhe do të kërkojë sqarim edhe nga Federata e Futbollit e Serbisë, sepse ajo e di fare mirë se nuk i lejohet të organizojë gara në territorin e një vendi tjetër anëtar të UEFA-s. FFK-ja kërkon nga të gjitha institucionet, presidenti, kryeministri, ministria e Sportit dhe grupi negociator për dialog me Serbinë, që të reagojnë për këtë çështje në organet ndërkombëtare, pasi veprimet e tilla janë mashtruese dhe qëllimkëqija për popullatën e asaj pjese të qytetit të Mitrovicës me rrethinë. Në rast se edhe në të ardhmen do të ketë aktivitete të tilla pa lejen e FFK-së, atëherë është e domosdoshme ndërhyrja e Policisë së Kosovës për ndalimin e tyre", thuhet në këtë reagim.

Federata e Futbollit e Kosovës ka rikujtuar edhe një herë se është organizata e vetme kompetente që organizon, udhëheq dhe rregullon garat në futboll në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe është themeluar në principet e frymës sportive dhe 'fair-play'-t dhe, si e tillë, edhe është anëtarësuar në UEFA e FIFA në maj të vitit 2016. "FFK-ja është e hapur për anëtare të reja dhe fton klubet e të gjitha komuniteteve që funksionojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës që të regjistrohen në institucionet shtetërore të Kosovës dhe të përfshihen në garat që organizohen nga FFK-ja. Federata e Futbollit, në mbështetje të institucioneve të sigurisë, u garanton të gjitha klubeve pjesëmarrëse siguri dhe 'fair-play' në gara", përfundon njoftimi i FFK-së.

## Buffoni, mes Portos dhe Atalantës

Porto dhe Atalanta janë opsionet më të mundshme për të ardhmen e Gianluigi Buffonit, pasi të dyja skuadrat janë pjesë e Ligës së Kampionëve në sezonin e ri. Portieri 41-vjeçar është lojtar i lirë pas largimit nga PSG-ja, ku qëndroi vetëm një sezon. Kërkesat e Buffonit për të luajtur rregullisht kanë bërë që skuadra franceze të mos i ofrojë një kontratë të re. Sipas Gianluca Di Marzio, skuadër favorite për ta transferuar Buffonin është Porto, që do ta zëvendësonte mikun e tij, Iker Casillas. Nëse Buffoni vendos të qëndrojë në Itali, atëherë opsion mbetet Atalanta që, po ashtu, do të garojë në Ligën e Kampionëve.




### SHKURT

#### Ardita e mbylli e fundit garën e parë në 'Minsk 2019'

Shigjetarja e vetme nga Kosova në Lojërat e dyta Evropiane "Minsk 2019", Ardita Zejnullahu, ka garuar në kualifikimet e disiplinës hark olimpik (recurve). Ardita doli e 48-ta nga po aq garues, duke fituar 500 pikë. Ajo u kualifikua për në 1/32 e finales. Shigjetarja më e mirë e Kosovës do të përballet me Michaela Bryony Pittman në garat që zhvillohen të martën.

#### Ferrari i Schumacherit, në ankand

Makina Ferrari, me të cilën Michael Schumacher dominoi në Botërorin e vitit 2002, ku u shpall kampion bote në Formula 1, do të dalë në ankand. Me këtë makinë piloti gjerman, shtatë herë kampion bote, fitoi në garën e Australisë, Brazilit, San Marinos, Spanjës, Austrisë, Kanadasë, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Belgjikës dhe Japonisë. Sipas specialistëve, kjo makinë Ferrari F2002 vlerësohet nga 5.5 deri në 7.5 milionë dollarë, shumë në të cilën pritet të nisë edhe ankandi. Gjithsesi, pritet që shitja e Ferrarit ta kalojë këtë shifër, për më tepër që bëhet fjalë për "kokëkuqen" e pilotuar nga legjenda Michael Schumacher.

#### Pensionohet Torresi

Fernando Torres ka bërë me dije se i ka dhënë fund karrierës si futbollist profesionist. Ish-sulmuesi i Atletico Madridit, Liverpoolit dhe Chelseat, ka bërë me dije se një fjalim lamtumirës do ta mbajë gjatë ditës së diel në Tokio, ku është paraqitur me skuadrën e Sagan Tosut. "Pas 18 vjetësh emocionuese, ishte koha që ta përfundoj karrierën time. Të dielën në orën 10:00 do të mbaj një konferencë për shtyp, ku do t'i shpjegoj të gjitha hollësitë. Shihemi atje", ka njoftuar Torresi përmes një videoje në "Twitter".

#### Murieli përforcon Atalantën

Sulmuesi nga Kolumbia, Luis Muriel, është futbollisti që e ka përforcuar skuadrën e Atalantës. Skuadra italiane e ka blerë për 18 milionë euro sulmuesin nga skuadra e Sevillas. 28-vjeçari ishte i huazuar në skuadrën e Fiorentinës, kurse për Atalantën ka nënshkruar kontratë katërvjeçare.

#### Milani refuzon Barçën për Romagnolin

AC Milan e ka refuzuar ofertën e Barcelonës për kapitenin Alessio Romagnoli. Gazeta italiane "Tuttosport" raporton se kampionia e Spanjës, Barcelona, kishte ofruar 40 milionë për mbrojtësin italian, por Milani nuk ka hezituar dhe e ka refuzuar ofertën e tyre për faktin se Romagnoli vlerësohet lojtar i paprekshëm. Barcelona është refuzuar edhe nga mbrojtësi i Ajaxit, Matthijs de Ligt.

#### Cechi rikthehet te Chelsea

Petr Cech është rikthyer te Chelsea pas përfundimit të karrierës si portier te "topçinjtë" e Arsenalit. Ish-gardiani çek do të mbajë një funksion tjetër pas largimit nga futbolli. 37-vjeçari do të fokusohet në këshillim teknik dhe të performancës në klub. Lajmi është bërë publik nga vetë klubi londinez nëpërmjet një njoftimi zyrtar. "Unë ndihem shumë i privilegjuar që kam këtë mundësi për t'u bashkuar sërish me Chelsean", ka deklaruar ish-portieri. Portieri çek e ka veshur fanellën e Chelseat nga vitet 2004 deri në 2015, teksa ka kaluar vitet më të suksesshme të karrierës. Më pas gardiani u transferua te rivalët e Arsenalit, ku u aktivizua për katër sezone, deri në përfundimin e karrierës.

**Autor: GAZMEND MORINA**

ATDHETARI DHE SHKRIMTARI NË FOTO
RREGULL E CAKTUAR LIGJORE OSE MORALE (shq.)
EMRI I KOMANDANT "KUMANOVA" (UÇK)
TEFIK OSMANI
NGJALLJE E KUJTIMEVE PËR DIKË
TONI ADAMS
EPOKA E RE
ALBANOLOGIA DURHAM
DOLLAP I VOGËL QË SHËRBEN PËR TË MBAJTUR ZOGJ
KRYEQYTETI JORDANEZ
LUMË NË SHQIPËRI
UMA TURMAN
ROTHERHAM
EPOKA E RE
KAFSHË E VISEVE TË AMERIKËS SË JUGUT (sh.shq.)
VEPËR KU SHËNOHESHIN VIT PËR VIT NGJARJET MË TË RËNDËSISHME TË KOHËS (sh.shq.)
BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT

BASHKIM I FORTË DHE I PANDASHËM
E PASUR
HARK; KTHESË / SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE (pashq.)

SHTETI YNË
GRUA A VAJZË QË VALLËZON ME NJË KAVALIER (sh.shq.) / NJË LLOJ PIJE ALKOOLIKE
QYTETI FRANCEZ I FILMIT / PËRÇUES I NJË QËLLIMI A PIKËSYNIMI (fig.)

SHKODRA, RIZONI, MITROVICA
ZANORE
SHKENCËTARI YNË GJOTA / RUANDA, UGANDA
THIKË QË MBAHET NË KËLLËF SI ARMË BREZI (sh.shq.) / FINLANDA, ESTONIA

PËREMËR PRONOR
BANOR I NJË QYTETI NË SHQIPËRI / QYTET NË ILIRI (shq.)
VDEKJEPRURËSE / LIVORNO

METAL I BUTË ME NGJYRË TË BARDHË SI TË ARGJENDIT
KAMBANË E VOGËL (sh.shq.)
VITI I RI KINEZ (pashq.) / HEROI ISA

BASHKËTINGËLLORE
GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat. - sh.shq.)
INVA MULA / SHKENCA MBI PAQENË



SHKRONJAT E PARA
"TENERIFE" / HEROI ISMAIL

BIMË QË MBILLET E RRITET NË NGASTRA ME UJË
GOTA PREJ METALI (shq.)
LEARNING ORIENTATION QUESTIONNA.
TROPOJA / UJËRA TË FËLLIQURA, QË DALIN NGA LARJA E SHPËLARJA E ENËVE

NJË LLOJ LETRASH FATI
SËMUNDJA E TOKËS, EPILEPSIA (pashq.) / ORGAN QENDROR I SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT TE NJERIU (pashq.) / AKTORJA AMERIKANE PORTMAN
RENS ISTVUD

AKTORJA JONË CAHANI

EPOKA E RE
KËNGËTARJA GJONI / EMRI I KOMANDANTIT LEGJENDAR të UÇK-së

BABAI
ISTRES / KRAHINË NË KOSOVË
KËNGËTARI YNË SHEHU

FUTBOLLISTI PORTUGEZ (Chelsea)
PAGJAKËSI
PRIJËS I HUNËVE / OKSIGJEN, NIKEL, RADIUM

FAZA
OLIVIER CANTON
E SHKALLËS MË TË ULËT A E CAKUT MË TË POSHTËM
ZANORE
TRANSMISI. ELECTRON MICROSCOPE
REGJISORI AMERIKANE STONE (shq.)
GATESË E JONA TRADICIONALE
ROTERDAM / E KAPA ME DORË (bised.)
AUSTRIA, LETONIA / GRUP MUZIKOR (shq.)

BASHKË, TOK
TINGULLIMIT-IM, FJALË TINGULLIMITU ESE / MËNJANIMI NGA GARA
LLOJ PAPAGALLI
BASHKËTINGËLLORE / BOLTON
BOLIVIA / DIREK I ÇATISË

EPOKA E RE
KËNGËTARI YNË AGIM / HEROI PRISHTINA
KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU / KËNGËTARJA FARA

BASHKËTINGËLLORE
ISLAM (perkdh.) / SATANI, DJALLI
QË KA MBETUR PA GOJË NGA HABIA, I SHTANGUR, I ....... / DAVID AGUER
"R" në mes të dy "N" / PËRÇARJE

SHKRIMTARI ASLLANI
JETË PA TRAZIME, JETË E QETË DHE E LUMTUR / INTER TOTO
PJESA E DALË NË TRAJTËN E NJË BALLKONI TË GJERË PËRPARA NJË NDËRTESE / ROBEN AGOS
LUTJA NË TË CILËN PRIFTI SHPREH DISA DËSHIRA PËR BESIMTARËT

NJË NGA VËLLEZËRIT FRASHËRI
EMËR FEMRE MYSLIMANE / FUTBOLLISTI ANGLEZ .... LENON (Totenham)
AKTORI YNË ISLAMI (shq.) / REKUIZITË SPORTIVE
ZANORE / BANOR I HERSHËM I NJË KRAHINE A I NJË VENDI

KËNGËTARJA AMERIKANE BAKER
ZANORE / EVERTON
VEPRIMTARI KRIJUESE ARTISTIKE / ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER
ALI ALIU / SYLEJMAN (perkdh.)
DUKAT / KËNGËTARJA E FAMSHME SKOCEZE LENOKS

PJESË E LIGJIT
DRAMATURGU ARBËRESHË JOSIP / "MOLDAVIA"
INTERNATIO. ORGANIZATION FOR MIGRATION / ALUMIN
ISH PILOTI I "Formula 1" AIRTON / PËREMËR VETOR

EPOKA E RE
AKTORI YNË FLLOKO / SHKRONJA E 16-të
SUPER MODELJA HERZIGOVA / ZANORE
KËPUCËT E POSAÇME PËR TË RRËSHQITUR MBI AKULL / TUNIZIA

AGRUME ME GJETHE GJITHNJË TË GJELBRA (shq.)
FUTBOLLISTI ..... LALA (shq.)
REGJISORI QOSJA

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: UNITET, E KAMUR, LAK, KOSOVA, DAMAT, KNA, SHRM, O, RIFAT, KAMAT, IME, KRUTAN, FATALE, NATIRUM, ZILET, TET, H, IM, AB, TE, ORIZ, LOQ, T, TAROT, ILET, IRENA, ZEMËR, INIS, NATALI, ATI, I, ATILA, DEKO, ONIRA, ETAPA, RI, AL, ME, ONOMATOPE, B, B, TEJECI, ELIZABETA, H, LAM, NEMITUR, NRN, ALI, IDIL, VERANDA, SAMI, AMIRE, ARDI, U, ANITA, A, ART, AA, AR, NEN, RELA, IOM, SENA, TIMO, EVA, PATINAT, LIMONI, ALTINI, ISA .

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
**Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë**
**Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije**
**Ministry of Education, Science and Technology**

| | | |
|---|---|---|
| **Kabineti i Ministrit** | **Kancelaria Ministra** | **Cabinet of Minister** |
| **Inspektorati i arsimit** | **Inspektorat za obrazovanje** | **Inspectorate of Education** |

Ref.10
Nr. 580
Datë: 20.06.2019

